



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 747 Akti

Nr. 801 Vendimi
Tiranë, më 19.9.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Genta Tafa (Bungo) Kryesuese

Roland Ilia Relator

Xhensila Pine Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, në datën 19.9.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Aulona Bodo**, me funksion ndihmëse ligjore pranë Gjykatës së Lartë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Roland Ilia, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, vëzhguesen ndërkombëtare, si dhe pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Aulona Bodo, e cila në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Aulona Bodo, me funksion ndihmëse ligjore pranë Gjykatës së Lartë, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).

2. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK); Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni ka hedhur shortin në qershor të vitit 2021, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Aulona Bodo do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues, i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Roland Ilia dhe Xhensila Pine. Relator i çështjes u zgjodh komisioneri Roland Ilia dhe kryesuese e trupit gjykues u caktua me mirëkuptim komisionere Genta Tafa (Bungo). Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit. Më pas u vendos fillimi i hetimit administrativ me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Aulona Bodo, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit.

4. Subjektit të rivlerësimit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjekti i rivlerësimit sipas kërkesës së Komisionit ka deklaruar mungesën e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

5. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm për të tria kriteret e vlerësimit: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; vlerësimi i aftësive profesionale.

6. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, pas përfundimit të hetimit të thelluar administrativ për të tria kriteret e vlerësimit - vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale, në datën 11.9.2024 vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit Aulona Bodo; (ii) njoftimin e subjektit për t’u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

7. Subjekti i rivlerësimit pas njoftimit mbi të drejtën e saj për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni, ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja, të cilat i paraqiti në rrugë zyrtare pranë Komisionit, në datën 17.9.2024.

8. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet e paraqitura dhe provat mbështetëse mbi rezultatet e hetimit, vendosi të ftojë znj. Aulona Bodo në seancë dëgjimore, e cila u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 19.9.2024, ora

10:00, në Pallatin e Koncerteve, salla B, kati 0, Tiranë, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare.

9. Subjekti i rivlerësimit mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionet e saj në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit Aulona Bodo kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrën e këshilltarit ligjor të Gjykatës së Lartë me statusin e magjistratit dhe emërimin si gjyqtare e Republikës së Shqipërisë.

II. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

10. Znj. Aulona Bodo ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur i janë kërkuar.

III. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI

11. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

12. Megjithëse sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror, referuar vendimit nr. 2/2017¹ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

13. Subjekti i rivlerësimit Aulona Bodo ushtron funksionin e ndihmësit/këshilltarit ligjor në Gjykatën e Lartë, që prej datës 3 nëntor 2014 dhe aktualisht. Ajo e ushtron këtë funksion pa ndërprerje që nga viti 2014.

A. RIVLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

14. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ka kryer një kontroll të plotë të deklaratës së pasurisë dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim ka konstatuar se për subjektin Aulona Bodo:

¹ “41. Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

- deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklaram të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

15. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit:

- Raportin e ardhur nga ILDKPKI-ja dhe dosjen për vlerësimin e pasurisë:
 - ✓ deklaratën *Vetting* të dorëzuar nga subjekti pranë ILDKPKI-së, sipas ligjit nr. 84/2016 dhe ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003;
 - ✓ dokumentet e ndodhura në dosjen e dërguar nga ILDKPKI-ja;
 - ✓ dokumentacionin e administruar nga institucionet publike dhe private sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
 - ✓ deklaramet e subjektit dhe provat e dërguara në përgjigje të pyetësorëve.
- Raportin e administruar nga AKSIK-ja për kontrollin e figurës:
 - ✓ formularin e plotësuar të kontrollit të figurës;
 - ✓ hetimin administrativ të Komisionit.
- Raportin profesional të administruar nga KLGJ-ja, për vlerësimin profesional:
 - ✓ dokumentet e ndodhura në dosjen e dërguar nga KLGJ-ja.

Në deklaratën e pasurisë, shtojca *, dorëzuar në ILDKPKI në datën 20.1.2017, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjekti ka deklaruar:**

1. Depozitë bankare pranë American Bank of Investments SA

1.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar depozitë bankare pranë American Bank of Investments SA, në monedhën lek, me numër llogarie ***, me vlerë 800,007 lekë, me zotërim 100%.

1.2 Si burim të krijimit të kësaj llogarie subjekti ka deklaruar të ardhurat nga paga, këstet e pagimit nga motra V.B (M) për shlyerjen e detyrimit të një shume që i kishte dhënë hua, si dhe interesat bankarë të fituar, evidentuar dhe të klasifikuar si vijon:

a) Kjo depozitë bankare në datën 24.1.2014 ka pasur në gjendje 5,127.11 lekë, burimi i së cilës kanë qenë të ardhurat nga paga. Kjo llogari bankare është shtuar fillimisht me vlerën prej 100,000 lekësh, të depozituara në datën 6.5.2014, dhe më pas me vlerën prej 100,000 lekësh, të depozituara në datën 7.5.2014. Kjo llogari është vendosur në depozitë bankare me afat pranë bankës Credit Agricole (sot American Bank of Investments SA) në monedhën lek, në vlerën 205,134.08 lekë. Burimi i krijimit të kësaj llogarie janë të ardhurat nga paga.

b) Kjo depozitë bankare është shtuar nëpërmjet pagimit të kësteve të shlyerjes së detyrimit nga motra ime V.B (M), së cilës i kam huajtur një shumë parash në vitin 2013. Kjo shlyerje kap në total një masë prej 960,000 lekësh, të paguara në këste sipas këtyre datave dhe shumave: (i) datë 22.9.2014, shlyer 250,000 lekë; (ii) datë 29.12.2015, shlyer 95,000 lekë; (iii) datë 18.3.2016, shlyer 30,000 lekë; (iv) datë 12.4.2016, shlyer 20,000 lekë; (v) datë 14.6.2016,

shlyer 10,000 lekë; (vi) datë 13.7.2016, shlyer 20,000 lekë; (vii) datë 8.11.2016, shlyer 15,000 lekë; (viii) datë 23.9.2016, shlyer 5,000 lekë; (ix) datë 23.9.2016, shlyer 15,000 lekë; (x) datë 17.10.2016, shlyer 100,000 lekë; (xi) datë 11.11.2016, shlyer 20,000 lekë; (xii) datë 7.12.2016, shlyer 5,000 lekë; (xiii) datë 20.12.2016, shlyer 15,000 lekë; (xiv) datë 21.12.2016, shlyer 100,000 lekë; (xv) datë 23.12.2016, shlyer 95,000 lekë; (xvi) datë 27.12.2016, shlyer 70,000 lekë; (xvii) datë 27.12.2016, shlyer 95,000 lekë.

c) Kjo depozitë është shtuar në total nga interesat e depozitës në masën neto prej 20,320.12 lekësh, nga data 25.1.2014 deri më 30.12.2016, në këtë mënyrë: (i) nga data 25.1.2014 deri më 25.7.2015 me vlerën 3,284.69 lekë; (ii) nga data 7.8.2015 deri më 9.11.2015 me vlerën 9,613.08 lekë; (iii) nga data 22.1.2016 deri më 9.11.2016 me vlerën 7,102.73 lekë; (iv) nga data 11.11.2016 deri më 30.12.2016 me vlerën 319.62 lekë.

ç) Kjo depozitë është pakësuar në total në vlerën prej 385,440 lekësh, nga data 25.1.2014 deri më 30.12.2016, në këtë mënyrë: (i) në datën 29.7.2015 tërhequr shuma prej 8,400 lekësh; (ii) në datën 9.11.2015 tërhequr shuma prej 9,620 lekësh; (iii) në datën 11.11.2016 tërhequr shuma prej 7,670 lekësh; (iv) në datën 11.11.2016 tërhequr shuma prej 350,000 lekësh; (v) në datën 30.12.2016 tërhequr shuma prej 9,750 lekësh. Kjo depozitë, pavarësisht shtesave dhe pakësimeve që ka pasur në kohë, po deklarohet në masën që është aktualisht në momentin e plotësimit të deklaratës, në vlerën 800,007.23 lekë.

Subjekti i ka bashkëlidhur këtij deklarami vërtetimin nga ABI Bank²:

1.3 Po kjo bankë³ ka konfirmuar depozitë në emër të znj. Aulona Bodo, me gjendje në datën 20.1.2017 në vlerën 800,000 lekë dhe llogari kursimi me gjendje 7.23 lekë.

Hetimi i Komisionit

1.4 Në përgjigjen e ardhur nga ABI Bank⁴ konfirmohet llogari kursimi të hapur në datën 16.8.2005 pranë ish-Emporiki Bank (sot ABI Bank), në emër të subjektit, në monedhën lek. Vlera e kësaj llogarie ndër vite është shtuar nga depozitime të reja, por edhe nga interesat e përfituar nga depozitat në të cilën kalonin kursimet e subjektit para fillimit të detyrës. Këto depozita rinovoheshin kohë pas kohe ndër vite. Nga *statement*-i bankar i kësaj llogarie konstatohet se në datën 24.5.2013 gjendja e llogarisë së kursimit në emër të znj. Aulona Bodo ishte në vlerën 1,012,286.37 lekë. Në datën 27.5.2013, subjekti tërheq vlerën 1,007,200 lekë dhe sipas deklaramit të saj në rubrikën e të dhënave konfidenciale, nga kjo vlerë ajo i ka dhënë motrës së saj V.B (M) një hua prej 1,000,000 lekësh me qëllim blerje shtëpie banimi.

1.5 Komisioni ka analizuar mundësinë e subjektit dhe familjarëve të saj për krijimin e të gjitha pasurive të tyre familjare (përfshirë likuiditetet bankare të të gjithë familjarëve) deri në vitin 2011. Në këtë vit totali i llogarisë së kursimit (200,000 lekë) dhe llogarisë së depozitës (800,000 lekë) në të njëjtën bankë në emër të subjektit arrijnë një total prej 1,000,000 lekësh, të cilat më pas do të shërbejnë si burim për huadhënien e bërë në vitin 2013 motrës së saj V.B .

² Vërtetim bankar nga ABI Bank nr. ***, datë 20.1.2017, për gjendjen në llogarinë e znj. Aulona Bodo, në vlerën 800,007.23 lekë.

³ Me shkresën nr. *** prot., datë 21.7.2017.

⁴ Me shkresën nr. *** prot., protokolluar me nr. ***, datë 8.6.2023.

Analiza financiare e mundësisë së krijimit të pasurive dhe likuiditeteve deri në vitin 2011

Përshkrimi	1994 – 2011
PASURI	5,776,567
Apartament 75 m ² , lagjja “****”, Elbasan - 1993	21,931
Apartament 63 m ² , rruga “****”, Tiranë - 1996	1,400,000
Apartament 75 m ² , rruga “****”, Tiranë – nëna dhe babai i subjektit - 2002	1,900,000
Truall 1,150 m ² + ndërtesë 48 m ² , *** - babai i subjektit - 1999 - 1/21	0
Likuiditete <i>cash</i> dhe bankë	2,454,636
DETYRIME	0
PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)	5,776,567
TË ARDHURA TË DOKUMENTUARA	20,452,935
Të ardhura nga paga, subjekti	3,881,241
Të ardhura nga paga dhe pensioni, babai i subjektit	3,067,172
Të ardhura nga paga dhe pensioni dhe vendimi i gjykatës, nëna e subjektit	6,913,247
Të ardhura nga aktivitet privat, nëna e subjektit	1,400,000
Të ardhura nga motra e subjektit, S	352,974
Të ardhura nga interesi	488,302
Të ardhura nga shitja e apartamentit në Elbasan - 1996	1,000,000
Të ardhura nga shitja e apartamentit në rrugën “****”, Tiranë - 2001	3,350,000
SHPENZIME	7,905,855
Shpenzime jetese	7,842,355
Shpenzime për tatim nga shitja e pasurive të paluajtshme	63,500
Analiza e dokumentuar	6,770,512

1.6 Nga analiza financiare duket se subjekti dhe familjarët e saj kishin të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e pasurive dhe likuiditeteve të tyre deri në vitin 2011 (përfshirë depozitën e subjektit në vlerën 1,000,000 lekë pranë ABI Bank).

1.7 Nga kjo analizë financiare rezultoi se subjekti kishte mundësi t’i jepte motrës së saj V.B (M) hua në vlerën 1,000,000 lekë, në vitin 2013, me burime të ligjshme.

1.8 Gjithashtu, sipas *statement*-it bankar të kësaj llogarie, konstatohet se pas kësaj tërheqjeje të bërë nga subjekti para detyrës ajo ka shtuar në llogari 200,000 lekë në maj të vitit 2014 (para fillimit të detyrës), të cilat më pas i vendos në depozitë kursimi. Në datën 22.9.2014, motra e saj V.B depoziton në këtë llogari vlerën 250,000 lekë, me përshkrimin “Shlyerje e pjesshme e detyrimit në llog. të Aulona Bodo”. Kjo vlerë vendoset në depozitë kursimi në datën 30.9.2014. Kështu që para fillimit të detyrës, në datën 3.11.2014, subjekti ka dy depozita në vlerat 200,000 lekë dhe 250,000 lekë pranë ABI Bank.

1.9 Komisioni hartoi analizën financiare të mundësisë së krijimit të pasurive dhe gjithë likuiditeteve bankare dhe jobankare (cash) nga subjekti dhe familjarët e saj para fillimit të detyrës (deri në datën 3.11.2014).

Analiza financiare e mundësisë së krijimit të pasurive dhe likuiditeteve para fillimit të detyrës

Përshkrimi	1994 – 3.11.2014
PASURI	4,908,750
Apartament 75 m ² , lagjja “****”, Elbasan - 1993	21,931
Apartament 63 m ² , rruga “****”, Tiranë - 1996	1,400,000
Apartament 75 m ² , rruga “****”, Tiranë – nëna dhe babai i subjektit - 2002	1,900,000
Truall 1,150 m ² + ndërtesë 48 m ² , *** – babai i subjektit - 1999 - 1/21	0
Likuiditete <i>cash</i> dhe bankë	1,586,819
DETYRIME	-1,877,175
Dhënë hua motrës V.B (M) - 1,000,000 lekë - 2013	-750,000
Dhënë nëna hua V - 1,200,000 lekë - 2013	-1,120,000
Kredi S - 150,000 lekë - 2012	-6,267
Kredi S - 30,000 lekë - 2013	-908
PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)	6,785,925
TË ARDHURA TË DOKUMENTUARA	26,006,887
Të ardhura nga paga, subjekti	6,460,952
Të ardhura nga paga dhe pensioni, babai i subjektit	3,821,230
Të ardhura nga paga dhe pensioni dhe vendimi i gjykatës, nëna e subjektit	8,116,615
Të ardhura nga aktivitet privat, nëna e subjektit	1,400,000
Të ardhura nga motra e subjektit S	1,107,813
Të ardhura nga interesi	750,277
Të ardhura nga shitja e apartamentit në Elbasan - 1996	1,000,000
Të ardhura nga shitja e apartamentit në rrugën “****”, Tiranë - 2001	3,350,000
SHPENZIME	10,609,220
Shpenzime jetese	9,697,970
Shpenzim për tatim nga shitja e pasurive të paluajtshme	63,500
Shpenzime rivlerësimi ap. në Tiranë - 2013	81,125
Shpenzime mjekësore, nëna e subjektit - 2014	500,000
Shpenzime udhëtimi	266,625
Analiza e dokumentuar	8,611,743

1.10 Nga analiza financiare, rezultoi se subjekti dhe familjarët e saj kishin burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e gjithë pasurive dhe likuiditeteve bankare dhe *cash* (200,000 lekë, deklaruar nga subjekti në deklaratën para fillimit të detyrës) deri në datën e fillimit të detyrës (3.11.2014).

1.11 Pas fillimit të detyrës e deri në datën 31.12.2016, në llogarinë e kursimit në emër të subjektit janë bërë disa depozitime nga motra V.B (M), në vlerën totale 710,000 lekë, për likuidime të pjesshme të huas së marrë nga subjekti në vitin 2013 (në vlerën 1,000,000 lekë), duke shtuar gjendjen e llogarisë së bashku me interesat e përfituar nga kalimi i këtyre vlerave në depozita kohë pas kohe, ku, deri në datën 30.12.2016, gjendja e llogarisë së kursimit në emër të subjektit ishte në vlerën 809,757.23 lekë. Nga kjo vlerë, shuma 800,000 lekë kalon në

depozitë në të njëjtën bankë. Kjo depozitë është ajo që ka deklaruar subjekti në deklaratën *Vetting*.

1.12 Nga analiza financiare rezultoi se subjekti kishte burime të ligjshme për krijimin e depozitës së dhënë hua motrës së saj. Prandaj edhe kthimi i huas nga motra në vlerën totale prej 960,000 lekësh, deri në datën 31.12.2016, është konsideruar burim i ligjshëm për krijimin e depozitës në vlerën 800,000 lekë në emër të subjektit. Gjithashtu, sipas analizës financiare, rezultoi se subjekti kishte mundësi për shtimin e vlerës 200,000 lekë në llogarinë e vet në vitin 2014 (para fillimit të detyrës).

1.13 Sa më sipër, vërtetohet burimi i ligjshëm i depozitës bankare të deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting* dhe llogarisë së kursimit të lidhur me këtë depozitë.

Në përfundim të hetimit, Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e depozitës së deklaruar në deklaratën *Vetting*.

2. Llogari bankare në monedhën euro pranë American Bank of Investments SA

2.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar depozitë në ABI Bank, me vlerë 3,670 euro, duke sqaruar se disponon pranë American Bank of Investments SA, llogarinë bankare në monedhën euro, krijuar në datën 17.10.2016, në vlerën 3,730 euro. Zotërimi 100%.

2.2 Si burim të krijimit të kësaj llogarie subjekti ka deklaruar kursimet nga të ardhurat nga paga gjatë vitit 2016.

2.3 Sipas subjektit, nga këto llogari janë transferuar 3,700 euro neto në llogarinë bankare të shoqërisë “****” me qendër në Gjermani, me qëllim blerjen e një automjeti, si dhe janë paguar 25 euro komision dhe shpenzime bankare. Në kushtet kur automjeti i porositur për t’u blerë në Gjermani nuk rezultoi në gjendje teknike të mirë, pas anulimit të blerjes i është kthyer vlera prej 3,700 euro. Pas pagimit të shërbimit për transfertën e kryer nga banka, rezultoi vlera prej 3,670.5 euro.

2.4 Subjekti i ka bashkëlidhur këtij deklarami dokumentet⁵:

- ABI Bank⁶ ka konfirmuar depozitë në emër të znj. Aulona Bodo, me gjendje në datën 20.1.2017, në vlerën 3,670.5 euro.

Hetimi i Komisionit

2.5 Në përgjigjen e ardhur nga ABI Bank⁷, kjo bankë ka konfirmuar llogarinë e rrjedhëse në monedhën euro në emër të subjektit, të hapur në datën 17.10.2016 përmes një derdhjeje në llogari nga znj. Aulona Bodo në këtë datë, në vlerën 3,730 euro.

2.6 Sipas *statement*-it bankar të kësaj llogarie, konstatohet se në të njëjtën datë është transferuar vlera 3,700 euro me përshkrimin “*Payment of ***: A ****”. Këto të dhëna konfirmohen edhe nga dokumenti *R.P.*, lëshuar nga shoqëria “****”, Gjermani, dhe nga kërkesë për transfertë fondesh në nisje tek ABI Bank, të paraqitura nga subjekti bashkëngjitur deklaratës së pasurisë.

⁵ Vërtetim bankar nga ABI Bank nr. ***, datë 20.1.2017, për gjendjen në llogarinë e znj. Aulona Bodo, në vlerën 3,671.5 euro; dokument bankar nga shoqëria “****” për znj. Aulona Bodo, për shumën 3,700 euro; kërkesë për transferim fondesh në ABI Bank, datë 17.10.2016, për shumën 3,700 euro (urdhërues A. Bodo e përfitues “****”, me qëllim pagesë për automjetin “****”).

⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 21.7.2017.

⁷ Me shkresën nr. *** prot., protokolluar me tonën me nr. ***, datë 8.6.2023.

Ndërkohë, vlera 3,700 euro rikthehet në llogarinë e subjektit, në datën 11.11.2016, për shkak të defektit të automjetit.

2.7 Në DPV-në e vitit 2016, subjekti e deklaroi hapjen e llogarisë pranë ABI Bank, në vlerën 3,730 euro, me burim kursimet nga të ardhurat nga paga e vitit 2016, si dhe deklaroi shtesat dhe pakësimet mbi të për shkak të transfertave të bëra për blerjen e automjetit dhe rikthimin e parave.

2.8 Komisioni analizoi si më poshtë mundësinë e subjektit për depozitim të vlerës 3,730 euro, në datën 17.10.2016, bazuar në burimin e deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe të konfirmuar edhe në përgjigje të pyetësorit ***, që janë kursimet e subjektit nga të ardhurat nga paga gjatë vitit 2016. Në këtë analizë financiare u morën parasysh të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit dhe ndryshimi i likuiditeteve të subjektit.

Analiza e mundësisë së depozitimit të vlerës 3,730 euro – 17.10.2016

Përshkrimi	Vlera
Të ardhura nga paga subjekti 1.1.2016 – 17.10.2016	922,014
Të ardhura nga interesi 1.1.2016 – 17.10.2016	7,803
Të ardhura totale 1.1.2016 – 17.10.2016	929,817
Shpenzime jetese 1.1.2016 – 17.10.2016	186,115
Shpenzime totale 1.1.2016 – 17.10.2016	186,115
Ndryshim likuiditeti 31.12.2015 – 17.10.2016	584,785
Mundësia financiare	158,917

2.9 Nga analiza financiare rezultoi se subjekti kishte burime të ligjshme të mjaftueshme për shtimin e likuiditeteve (përfshirë depozitim të vlerës 3,730 euro) dhe mbulimin e shpenzimeve të jetesës për periudhën 1.1.2016 – 17.10.2016.

Në përfundim të hetimit, Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti ka bërë deklaram të saktë, si dhe kishte burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e gjendjes bankare në vlerën 3,730 euro, në datën 17.10.2016.

3. Fond pensioni S , në emër të subjektit

3.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar fond pensioni S, me vlerë 21,188 lekë.

3.2 Subjekti deklaroi se nëpërmjet anëtarësimit në fondin e pensionit “S Pensions”, me kontratën nr. ****, datë 5.2.2013, zotëron 16.238 kuota individuale, të cilat i ka blerë në vlerën totale prej 18,000 lekësh. Gjithashtu, ajo deklaroi se nga data 31.7.2014 deri më 31.12.2016 numri i kuotave ka mbetur i pandryshuar, ndërsa vlera e tyre është shtuar dhe po deklarohet vlera e tyre në gjendjen aktuale.

3.3 Origjina e burimit për blerjen e këtyre kuotave janë të ardhurat nga paga.

3.4 Subjekti e deklaroi këtë investim për herë të parë në DPV-në e vitit 2015, duke theksuar se për shkak të vlerës së vogël është harruar të deklarohet në deklaratën para fillimit të detyrës dhe në DPV-në e vitit 2014.

3.5 Credins Invest⁸ ka konfirmuar se znj. Aulona Bodo është kliente prej datës 5.2.2013. Kontributet e derdhura në emër të znj. Aulona Bodo kanë kaluar në llogari nga paga e shtetases

⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 17.7.2017 dhe me shkresën nr. *** prot., datë 26.5.2023.

V.B , në cilësinë e të afërmit. Sipas të dhënave të dërguara përmes shkresave nga Credins Invest, shuma totale në datën 31.12.2016 ishte 21,188.36 lekë.

3.6 Referuar rezultatit pozitiv financiar të të gjithë periudhës së krijimit të këtij investimi nga ana e subjektit, që para fillimit të detyrës, kur ka ndodhur blerja e të gjitha kuotave të zotëruara, rezultoi se subjekti kishte mundësi financiare për blerjen e tyre.

Në përfundim të hetimit, Komisionit nuk i rezultuan problematika në lidhje me këtë llogari bankare. Deklarimi i subjektit dhe dokumentacioni i dorëzuar përputhen me përgjigjen e marrë nga Credins Invest.

4. Llogari bankare në BKT, në emër të subjektit

4.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar llogari bankare në BKT, me vlerë 11,797 lekë. Burimi i origjinës së tyre është nga paga e derdhur nga punëdhënësi Gjykata e Lartë. Zotërimi 100%.

4.2 BKT-ja⁹ ka konfirmuar llogari në emër të znj. Aulona Bodo, me gjendje në datën 20.1.2017, në vlerën 11,794.07 lekë.

4.3 Sipas përgjigjes së BKT-së në shkresën nr. *** prot., datë 12.6.2023, konfirmohet llogaria e pagës në monedhën lek, e cila në datën 31.12.2016 kishte gjendje vlerën 3,778.07 lekë. Ndërkohë, në datën 20.1.2017, kur është bërë edhe deklarimi i subjektit në deklaratën e pasurisë, gjendja e llogarisë ishte në vlerën 11,794.07 lekë.

4.4 Sipas *statement*-it bankar bashkëngjitur kësaj shkrese, në këtë llogari të hapur në datën 4.2.2013 ka kaluar paga e subjektit nga Agjencia e Mbështetjes Shoqërore Civile, Këshilli i Ministrave, grupi Task Forcë dhe, më pas, nga Gjykata e Lartë.

Në përfundim të hetimit, Komisionit nuk i rezultuan problematika në lidhje me këtë llogari bankare. Deklarimi i subjektit ishte i saktë dhe në përputhje me përgjigjen e BKT-së.

5. Gjendje cash

5.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në vlerën 50,000 lekë (deri në datën 20.1.2017). Pjesa takuese: 100%. Si burim krijimi subjekti ka deklaruar kursimet nga paga.

5.2 Subjekti ka deklaruar për herë të parë kursime *cash* në deklaratën para fillimit të detyrës të datës 27.11.2014 me shprehjen “*Gjendje cash në shtëpi, si rezultat i kursimeve nga paga, në vlerën 200,000 lekë*”.

5.3 Ndërkohë, në DPV-në e vitit 2014, nuk ka deklaruar ndryshime nga deklarata paraardhëse.

5.4 Në DPV-në e vitit 2015, subjekti deklaroi: “*Gjendje cash si rezultat i kursimeve nga paga në fund të vitit 2015, në vlerën 250,000 lekë - 100%*”.

5.5 Në DPV-në e vitit 2016, subjekti deklaroi: “*Gjendje cash si rezultat i kursimeve nga paga në fund të vitit 2016, në vlerën 50,000 lekë - 100%*”.

5.6 Komisioni konstatoi se vlera progresive e kursimeve *cash* në fund të vitit 2016, e deklaruar nga subjekti, përputhet me gjendjen e deklaruar në deklaratën *Vetting* të datës 20.1.2017.

⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 17.7.2017.

5.7 Referuar analizës financiare para fillimit të detyrës së subjektit dhe familjarëve të saj, rezultoi se subjekti kishte burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e kursimeve *cash* në vlerën 200,000 lekë, deri në datën 3.11.2014.

5.8 Lidhur me mundësitë financiare të subjektit për krijimin e gjendjes *cash* në periudhën 3.11.2014 – 31.12.2016, referuar analizës financiare më poshtë, rezultoi se subjekti kishte mundësi për krijimin e gjendjes *cash* në vlerën 50,000 lekë.

6. Dhënie huaje motrës në vlerën 1,000,000 lekë

6.1 Tek rubrika e të dhënave konfidenciale, në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar se i ka dhënë hua motrës V. B (M), në maj të vitit 2013, shumën prej 1,000,000 lekësh, pa afat dhe pa asnjë dokument shkresor, me qëllim blerjen e një shtëpie banimi.

6.2 Origjina e kësaj sasive të hollash vjen nga depozita bankare në monedhën lek, që subjekti ka pasur pranë institucionit bankar të nivelit të dytë, banka Credit Agricole (sot Amerikan Bank of Investments SA), në vlerën prej 1,012,198 lekësh.

6.3 Si burim krijimi të kësaj depozite, subjekti ka deklaruar të ardhurat e siguruar nga paga e saj për një periudhë gati 10-vjeçare pune. Nga kjo shumë, shtetasja V. B (M) i ka shlyer në total 960,000 lekë, deri në datën e plotësimit të deklaratës *Vetting*, 20.1.2017. Këto shuma janë evidentuar në deklaratën *Vetting* edhe në formën e pasurive që subjekti disponon. Ka mbetur për t'u shlyer shuma 40,000 lekë.

Hetimi i Komisionit

6.4 Subjekti e ka deklaruar këtë marrëdhënie huaje që në deklaratën para fillimit të detyrës, të dorëzuar në datën 27.11.2014. Ndërkohë, ajo ka deklaruar edhe shlyerjet pjesore të bëra nga motra e saj në DPV-në e viteve 2015 dhe 2016.

6.5 Nga *statement*-i bankar i llogarisë së subjektit pranë ABI Bank¹⁰, konstatohet se subjekti tërheq në datën 27.5.2013 shumën 1,007,200 lekë dhe sipas deklaramit të saj kjo shumë i është dhënë hua motrës V.B (M). Deri në fund të vitit 2016, motra V. B (M) i kthen në llogari subjektit 960,000 lekë.

6.6 Sipas analizës financiare të mundësisë së krijimit të pasurive dhe likuiditeteve të subjektit dhe familjarëve të saj deri në vitin 2011, të paraqitur në pikën 1 të këtij vendimi, rezultoi se subjekti kishte mundësi financiare për krijimin e gjendjes bankare prej 1,000,000 lekësh, e cila është gjendje në llogari deri në datën 27.5.2014, kur subjekti i jep hua motrës V.B (M).

6.7 Sa më sipër, Komisionit nuk i rezultuan problematika lidhur me këtë marrëdhënie huaje.

7. Dhënie huaje nënës në vlerën 500,000 lekë

7.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar se i ka dhënë hua nënës së saj, N.F (B), një shumë të hollash prej 500,000 lekësh, për përballimin e një ndërhyrjeje mjekësore në vitin 2014 dhe kurimin pas saj, pa afat dhe pa dokument shkresor. Subjekti ka deklaruar se nuk ka asnjë ndryshim në shlyerjen e kësaj shume.

7.2 Subjekti e ka deklaruar këtë hua edhe në deklaratën para fillimit të detyrës të dorëzuar në datën 27.11.2014.

¹⁰ Shihni shkresën nr. *** prot., protokolluar me tonën me nr. ***, datë 8.6.2023.

7.3 Në analizën financiare, kjo vlerë është përfshirë si shpenzim i bërë nga subjekti dhe familjarët e saj në periudhën para fillimit të detyrës (deri në datën 3.11.2014) dhe për të cilën subjekti kishte mundësi financiare për dhënien e kësaj huaje nënës së saj.

Deklarimi i pasurive të babait të subjektit, M.B

8. Apartament me sipërfaqe 75 m², blerë në vitin 2002, me çmimin 1,900,000 lekë - ½ pjesë

8.1 Në deklaratën *Vetting*, babai i subjektit ka deklaruar: “*Apartament me sip. 75 m², blerë në vitin 2002, me çmimin 1,900,000 lekë. Zotërimi: 50% babai + 50% nëna. Bashkëpronar në ½ pjesë të një pasurie të paluajtshme, apartament banimi (sipërfaqe ndërtimi e përshtatur për banim) me sip. 75 m², ndodhur në rr. “****”, vila nr. ***, kati i dytë, ap. ***, Tiranë. Bashkëpronari tjetër i kësaj pasurie të paluajtshme është bashkëshortja ime N.F (B), që disponon pjesën tjetër saj, po në ½ pjesë*”.

8.2 Ky apartament është blerë në datën 25.5.2002, në vlerën 1,900,000 lekë, nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.5.2002 dhe është regjistruar në ZVRPP-në Tiranë, në llojin e pasurisë “njësi”.

8.3 Si burim financiar për blerjen e kësaj pasurie deklarohet vlera e shitjes së apartamentit në rrugën “****”, prej 3,350,000 lekësh, nëpërmjet kontratës së shitblerjes datë 5.11.2001.

8.4 Babai i subjektit ka deklaruar se apartamenti i ndodhur në rrugën “****” është blerë prej tij në vlerën 1,400,000 lekë, në vitin 1996. Origjina e burimeve financiare për blerjen e këtij apartamenti ka qenë vlera e shitjes së apartamentit që ka pasur në bashkëpronësi me bashkëshorten N.B, në qytetin e Elbasanit, ***, pallatet pranë Z.

8.5 Këtë pasuri, prindërit e subjektit e kanë përfutur nëpërmjet kontratës së privatizimit, bazuar në ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”, të cilët nuk disponojnë kopje të këtyre akteve.

8.6 Pasuria e paluajtshme apartament banimi (sipërfaqe ndërtimi i përshtatur për banim) me sip. 75 m², e ndodhur në rrugën “****”, vila nr. ***, kati i dytë, ap. ***, Tiranë, e cilësuar “njësi” në certifikatën e pronësisë, me vlerë 1,900,000 lekë, është vlerësuar në vlerën 10,012,500 lekë, në datën 29.8.2013.

8.7 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacionin ligjor¹¹.

Hetimi i Komisionit

8.8 ZQRPP-ja¹² ka konfirmuar se në emër të subjektit nuk figuron asnjë pasuri e paluajtshme e regjistruar. Ndërsa konfirmon se në emër të shtetasve M dhe N.B ka të regjistruar pasurinë e llojit apartament me sip. 75 m², blerë në vitin 2002 nga shtetasit e sipërcituar, në vlerën 1,900,000 lekë.

8.9 Subjekti ka paraqitur kontratat e blerjes dhe të shitjes së apartamenteve nga prindërit e saj (përveç kontratës së privatizimit), deri në apartamentin aktual.

¹¹ Certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 30.5.2014, për pasurinë nr. ***, e llojit njësi me sip. 75 m², në pronësi të shtetasve M dhe N.B; kartelë pasurie e njësisë. Në sektorin e përshkrimit të veçantë rezulton se pasuria është rivlerësuar në datën 29.8.2013 me vlerë 10,012,500 lekë.

¹² Me shkresën nr. *** prot., datë 26.12.2017.

8.10 ASHK Drejtoria Vendore Elbasan me shkresën nr. *** prot., datë 10.7.2023, konfirmon se në emër të shtetasve M.J.B dhe N.S.B ka qenë e regjistruar pasuria nr. *** e llojit apartament, me sip. 75 m², ndodhur në lagjen “****”, pallati ***, shkalla ***, kati ***, ap. ***, regjistruar me kontratë shitjeje privatizimi me EKB-në Elbasan (ish-Ndërmarrja Komunale) nr. ***/***, datë 21.6.1993, në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 21.6.1993, në vol. ***, fq. ***, z. k. ***, Bashkia Elbasan, shitur në datën 29.8.1996, në vlerën 1,000,000 lekë.

8.11 Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka sjellë kontratën e shitblerjes të datës 12.9.1996 për blerje apartamenti, në rrugën “****”, Tiranë, me sip. 63 m², me çmim shitjeje 1,400,000 lekë, si dhe kontratën e shitjes të datës 5.11.2001 për shitje apartamenti me sip. 63 m², në rrugën “****”, kundrejt vlerës 3,350,000 lekë.

8.12 ASHK Drejtoria Vendore Tirana Jug me shkresën nr. *** prot., datë 10.7.2023, referon dëshminë e trashëgimisë ligjore të datës 6.12.2021, sipas së cilës trashëgimlënësi M.J.B ka si trashëgimtarë ligjorë bashkëshorten N.S.B dhe vajzat V, Aulona dhe S.B, të cilat trashëgojnë nga ¼ pjesë të pasurisë së trashëguar. Bashkëngjitur shkresës është dhe kontrata e shitjes nr. ***/***, datë 25.5.2002, me palë shitëse L.M dhe palë blerëse M dhe N.B dhe me objekt shitblerje sipërfaqe ndërtimi 75 m² në rrugën “****”, vila nr. ***, kundrejt çmimit 1,900,000 lekë.

8.13 Rezulton se shtetasja N.F (B) e ka privatizuar apartamentin me sip. 75 m² në Elbasan, në vitin 1993, kundrejt një pagese prej 21,931 lekësh dhe e ka shitur në vitin 1996, në vlerën 1,000,000 lekë. Më pas, shtetasi M.B ka blerë apartamentin me sip. 63 m² në rrugën “ ****”, Tiranë, me çmimin 1,400,000 lekë dhe e ka shitur atë në fund të vitit 2001 me çmimin 3,350,000 lekë. Pas kësaj, shtetasit M dhe N.B kanë blerë në vitin 2002 njësinë e përshtatur për banim me sip. 75 m² në rrugën ****”, Tiranë, me çmimin 1,900,000 lekë.

8.14 Sipas deklaratimit të bërë nga babai i subjektit në deklaratën *Vetting*, burimi i blerjes së njësisë me sip. 75 m² në rrugën “****”, me çmim 1,900,000 lekë, kanë qenë të ardhurat nga shitja e apartamentit në rrugën “****”, në vlerën 3,350,000 lekë.

8.15 Sa më sipër, duket se prindërit e subjektit kishin mundësi për blerjen e pasurisë me sip. 75 m² në rrugën “****”, në vitin 2002.

Për sa më sipër, nuk u konstatuan problematika lidhur me këtë pasuri, në të cilën subjekti ka jetuar së bashku me familjarët e saj deri në vitin 2020, vit kur është shkëputur nga trangu familjar për të bashkëjetuar me bashkëjetuesin e saj, z. A. J.

9. Ndërtesë me sipërfaqe 48 m² dhe truall me sipërfaqe 1150 m², në K , Vlorë

9.1 Në deklaratën *Vetting*, babai i subjektit ka deklaruar: “*Ndërtesë me sip. 48 m² dhe truall me sip. 1150 m², në K , Vlorë. Përfutuar nëpërmjet trashëgimisë. Zotërimi 1/21 pjesë*”.

9.2 Bashkëpronar në 1/21 pjesë të një pasurie të paluajtshme të përbërë nga një ndërtesë me sip. 48 m² dhe truall me sip. 1150 m², ndodhur në vendin e quajtur “****”, gadishulli i Karaburunit, me kufij kullotat e të zotëve.

9.3 Origjina e prejardhjes së kësaj pasurie është vendimi gjyqësor nr. ***, datë 1.4.1999, i Gjykatës së Apelit Vlorë, i cili është regjistruar në ZVRPP-në Vlorë në numrin hipotekor ***, datë 21.7.2000.

9.4 Kjo pasuri është fituar nëpërmjet trashëgimisë ligjore nga trashëgimlënësi J. V. B , të cilit i është njohur dhe i është kthyer kjo pasuri në bashkëpronësi me shtetasit S. V. B dhe Sh. A. B , duke gëzuar secili nga 1/3 pjesë.

9.5 Për këtë pasuri nuk është bërë vlerësimi në vlerë monetare. Bashkëpronarët e tjerë janë trashëgimlënësit e tjerë ligjorë të subjektit J. V. B , si dhe të subjekteve S. V. B dhe Sh. A. B . Zotërimi 4.75%.

9.6 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacionin ligjor¹³.

9.7 ZVRPP Vlorë ka konfirmuar të regjistruar pasuri ndërtesë me sipërfaqe 48 m² dhe sipërfaqe trualli 1150 m², në ***, K, Vlorë, në emër të trashëgimtarëve ligjorë, ndër të cilët shtetasi M.B, pjesëtar me 1/7 e 1/3 pjesë.

Në përfundim të hetimit, Komisioni arriti në konkluzionin se përputhet deklarimi dhe dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit me përgjigjen e ZVRPP-së Vlorë.

10. Në deklaratën *Vetting*, babai i subjektit ka deklaruar:

- **Depozitë në BKT me vlerë 536 USD;**
- **Depozitë në BKT me vlerë 500,053 lekë;**
- **Cash 150.000 lekë (deri në datën 20.1.2017).**

10.1 Burimi i krijimit të depozitave dhe gjendjes *cash* është nga të ardhurat familjare në vite (kursime), si dhe kursimet nga pensioni. Zotërimi 100%.

10.2 BKT-ja, sipas dokumentit nxjerrje llogarie të datës 5.1.2017 dhe sipas përgjigjes ndaj Komisionit me nr. *** prot., datë 12.6.2023, konfirmon depozita në emër të shtetasit M.B, me gjendje në datën 27.1.2017, në vlerat 536 USD dhe 500,053.83 lekë.

10.3 Sipas *statement*-it bankar të llogarive, konstatohet se ato janë krijuar që në vitin 2013 dhe kanë pësuar shtesa e pakësime të tjera në vazhdim. Referuar analizës financiare para fillimit të detyrës së hartuar nga Komisioni për subjektin dhe familjarët e saj deri në datën 3.11.2014, rezultoi se subjekti dhe familjarët e saj kishin burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e të gjitha pasurive të zotëruara deri në atë datë (përfshirë këto dy depozita në emër të babait të subjektit), si dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera të periudhës.

10.4 Nga llogaritë në lek dhe euro në emër të babait të subjektit pranë BKT-së, duket se janë tërhequr shumat e deklaruara si të dhëna hua vajzës S , në vitin 2016.

10.5 Rezultoi se përputhet deklarimi i subjektit dhe dokumentacioni i paraqitur me përgjigjen e BKT-së.

10.6 Lidhur me mundësitë financiare të babait të subjektit për krijimin e gjendjes *cash* në periudhën 3.11.2014 – 31.12.2016, referojuni analizës financiare në pikën 22 të këtij vendimi.

11. Dhënie huaje në shumat 400,000 lekë dhe 1,000 USD

11.1 Tek rubrika e të dhënave konfidenciale, në deklaratën *Vetting*, babai i subjektit ka deklaruar se i ka dhënë hua vajzës së tij, S.B, në korrik të vitit 2016, shumat 400,000 lekë dhe

¹³ Vërtetim nga dokumenti hipotekor nr. ***, datë 21.7.2000, për pasurinë me sip. 48 m² ndërtesë + 1150 m² truall, në ***, K, Vlorë, në pronësi të shtetasve S, M, E, A, M, L dhe B.B; vendimet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë për lëshimin e dëshmimeve të trashëgimisë ligjore për trashëgimtarët B.

1,000 USD, pa afat dhe pa asnjë dokument shkresor, me qëllim për të kryer pagesën e semestrit të parë të studimeve pasuniversitare që po ndjek në W.S.U Michigan, USA.

11.2 Origjina e këtyre shumave vijnë nga depozita bankare në monedhat lek dhe dollar që babai i subjektit kishte pranë BKT-së, burimi i krijimit të së cilave janë të ardhurat e përfituara nga puna në vite, kursimet familjare, si dhe pensioni shtetëror. Nga këto shuma nuk është shlyer asnjë këst deri në datën 20.1.2017.

11.3 Subjekti nuk ka paraqitur dokumente justifikuese në lidhje me këtë marrëdhënie juridike, por, për shkak të marrëdhënies së posaçme, siç është marrëdhënia prind-fëmijë, Komisioni nuk krijoi dyshime në lidhje me këtë marrëdhënie.

11.4 Referuar *statement*-it bankar të llogarive në emër të babait të subjektit pranë BKT-së¹⁴, rezulton se ai ka tërhequr vlerat 400,000 lekë dhe 1,000 USD në datën 27.7.2016.

11.5 Këto dy llogari janë trajtuar më sipër, në pikën 10 të këtij vendimi.

11.6 Sa më sipër, rezultoi se babai i subjektit kishte burime të ligjshme të mjaftueshme për t'i dhënë hua vajzës S. B shumat e deklaruara për studime.

Komisionit nuk i rezultuan problematika në lidhje me këtë hua, dhënë së bijës. Babai i subjektit kishte mundësi t'i jepte së bijës shumat e sipërpërmendura.

Deklarimi i pasurive të nënës së subjektit, N.B

12. Apartament me sipërfaqe 75 m², blerë në vitin 2002, me çmimin 1.900.000 lekë - 1/2 pjesë (trajtuar më sipër, në pikën 8 të këtij vendimi)

13. Dy llogari dhe një depozitë në Intesa Sanpaolo Bank:

- a) Llogari pranë Intesa Sanpaolo Bank, vlera 375.36 euro;
- b) Llogari rrjedhëse pranë Intesa Sanpaolo Bank, vlera 406.46 lekë;
- c) Depozitë pranë Intesa Sanpaolo Bank, vlera 409,000 lekë.

13.1 Në deklaratën *Vetting*, nëna e subjektit ka deklaruar se *disponon pranë Intesa Sanpaolo Bank llogarinë bankare në monedhën euro, në vlerën 375.36 euro, llogarinë rrjedhëse në monedhën lek, në vlerën 406.46 lekë dhe depozitën bankare në monedhën lek, në vlerën 409,000 lekë.*

Burim të krijimit të këtyre llogarive e depozitës janë kursimet nga të ardhurat e siguruara nga puna në vite (privat dhe shtet), të ardhurat familjare, të ardhurat nga pensioni suplementar dhe ai i pleqërisë, si dhe këstet e shlyerjes së detyrimit nga vajza ime V. B (M), për shumën që i kam dhënë hua për blerjen e një shtëpie.

Llogaria rrjedhëse prej 406 lekësh ka mbetur si e tillë, pasi është vënë në depozitë me afat shuma prej 409,000 lekësh.

13.2 Intesa Sanpaolo Bank¹⁵ vërteton se nëna e subjektit, N.B, ka llogari e depozitë, me gjendje në vlerat përkatësisht 375.36 euro; llogari rrjedhëse 406.46 lekë; depozitë 409,000 lekë.

¹⁴ Shihni përgjigjen e BKT-së nr. *** prot., datë 12.6.2023.

¹⁵ Nxjerrje llogarie datë 29.12.2016, shkresat nr. *** prot., datë 11.7.2017 dhe nr. *** prot., datë 6.6.2023.

13.3 Nga *statement*-i bankar rezulton se llogaria në lek është krijuar nga nëna e subjektit që në vitin 2006 si një llogari page dhe më pas janë shtuar vlera të tjera, duke krijuar një depozitë në vlerën 1,042,875 lekë deri në fund të vitit 2006. Kjo depozitë ka shërbyer më vonë si huadhënie në vlerën 1,200,000 lekë, dhënë vajzës V.B (M) në vitin 2013.

13.4 Pas kthimeve të pjesshme të huas nga shtetasja V.B, në datën 31.12.2016, gjendja e llogarisë rezultoi 406 lekë dhe gjendja e depozitës rezultoi 409,000 lekë.

Analiza financiare e mundësisë së krijimit të pasurive dhe likuiditeteve deri në vitin 2006

Përshkrimi	1994 – 2006
PASURI	4,716,842
Apartament 75 m ² , lagjja “****”, Elbasan - 1993	21,931
Apartament 63 m ² - rruga “****”, Tiranë - 1996	1,400,000
Apartament 75 m ² , rruga “****”, Tiranë - nëna dhe babai i subjektit - 2002	1,900,000
Truall 1150 m ² + ndërtesë 48 m ² , *** - babai i subjektit - 1999 - 1/21	0
Likuiditete cash dhe bankë	1,394,911
DETYRIME	0
PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)	4,716,842
TË ARDHURA TË DOKUMENTUARA	12,123,989
Të ardhura nga paga, subjekti	712,250
Të ardhura nga paga dhe pensioni, babai i subjektit	1,953,404
Të ardhura nga paga dhe pensioni dhe vendimi i gjykatës, nëna e subjektit	5,093,663
Të ardhura nga interesi	14,673
Të ardhura nga shitja e apartamentit në Elbasan - 1996	1,000,000
Të ardhura nga shitja e apartamentit në rrugën “****”, Tiranë - 2001	3,350,000
SHPENZIME	5,173,455
Shpenzime jetese	5,109,955
Shpenzim për tatim nga shitja e pasurive të paluajtshme	63,500
Analiza e dokumentuar	2,233,692

13.5 Nga analiza financiare rezultoi se subjekti dhe familjarët e saj kishin të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e pasurive dhe likuiditeteve të tyre deri në vitin 2006 (përfshirë depozitën e nënës subjektit në vlerën 1,042,875 lekë pranë ABI Bank). Prandaj, edhe nëna e subjektit kishte burime të ligjshme të mjaftueshme për t’i dhënë hua vajzës V.B (M) vlerën 1,200,000 lekë, në vitin 2013.

13.6 Sa më sipër, kthimi i huas nga vajza V.B në vlerën totale prej 314,000 lekësh deri në datën 31.12.2016, është konsideruar burim i ligjshëm për krijimin e depozitës në vlerën 409,000 lekë në emër të nënës së subjektit.

Komisioni arriti në konkluzionin se përputhet deklarimi i subjektit (nënës së saj) dhe dokumentacioni i paraqitur me përgjigjen e Intesa Sanpaolo Bank.

14. Gjendje cash në vlerën 120,000 lekë

14.1 Në deklaratën *Vetting*, nëna e subjektit ka deklaruar se disponon gjendje *cash* në vlerën 120,000 lekë, si rezultat i kursimeve personale deri në datën 20.1.2017.

14.2 Lidhur me mundësitë financiare të nënës së subjektit për krijimin e gjendjes *cash* në periudhën 3.11.2014 – 31.12.2016, referojuni analizës financiare në pikën 22 të këtij vendimi.

15. Në lidhje me shumat e dhëna hua 500,000 lekë dhe 1,200,000 lekë vajzave të saj

15.1 Tek rubrika e të dhënave konfidenciale, në deklaratën *Vetting*, nëna e subjektit ka deklaruar se *i ka dhënë hua vajzës së saj S.B, në korrik të vitit 2016, shumën prej 500,000 lekësh, pa afat dhe pa asnjë dokument shkresor, me qëllim për të kryer pagesën e semestrit të parë të studimeve pasuniversitare që po ndjek në W.S.U Michigan, USA. Origjina e kësaj shume parash vjen nga depozita bankare që kam pranë bankës Intesa Sanpaolo, burimi i krijimit të së cilës është nga të ardhurat e përfituara nga puna në vite (avokate, shtet), kursimet familjare, si dhe pensioni shtetëror dhe ai suplementar.*

Nga kjo shumë nuk i është shlyer asnjë këst deri në momentin e kryerjes së deklarimit në datën 20.1.2017.

15.2 Gjithashtu, nëna e subjektit, N. B, deklaroi se i ka dhënë hua vajzës së saj V. B (M), në maj të vitit 2013, shumën 1,200,000 lekë, pa afat dhe pas asnjë dokument shkresor, me qëllim blerjen e një shtëpie banimi. Origjina e kësaj sasive të hollash vjen nga depozita bankare që ka pasur pranë Intesa Sanpaolo Bank, në vlerën totale të saj prej 1,320,221.47 lekësh. Burimi i krijimit të kësaj depozite është dëmshpërblimi që ka përfutuar me vendim gjyqësor¹⁶ civil, ekzekutuar nga pala debitore Ministria e Drejtësisë, të ardhurat e përfituara nga puna si avokate, kursimet familjare, si dhe ato nga pensioni. Nga kjo shumë, nëna e subjektit ka deklaruar se vajza V.B i ka shlyer në total 314,000 lekë deri në datën 20.1.2017.

15.3 Kjo shumë është evidentuar në formën e pasurive që nëna e subjektit disponon. I ka mbetur për të shlyer edhe 886,000 lekë.

Hetimi i Komisionit

15.4 Lidhur me huadhënien e deklaruar si të dhënë vajzës S për studime në vitin 2016, në shumën 500,000 lekë, konstatohet se përveç kursimeve të tjera *cash* që mund të ketë pasur nëna e subjektit, ajo ka tërhequr nga llogaria e saj bankare pranë Intesa Sanpaolo Bank vlerën 400,000 lekë, në datën 27.7.2016.

15.5 Lidhur me huan e deklaruar si të dhënë ndaj vajzës V.B (M) në vitin 2013, nga *statement*-i bankar i llogarisë së nënës së subjektit pranë Intesa Sanpaolo Bank¹⁷ konstatohet se në datën 25.5.2013 nëna e subjektit tërheq vlerën 1,200,000 lekë. Sipas deklarimit të saj në rubrikën e të dhënave konfidenciale, nga kjo vlerë ajo i ka dhënë vajzës së saj V. B (M) një hua prej 1,200,000 lekësh me qëllim blerje shtëpie banimi.

15.6 Nga *statement*-i bankar konstatohet gjithashtu që motra e subjektit V.B (M) depoziton në llogarinë e nënës pranë Intesa Sanpaolo Bank gjithsej 314,000 lekë deri në datën 31.12.2016.

¹⁶ Vendimi i sipërcituar nr. ***, datë 5.10.2004, i Gjykatës së Apelit Tiranë.

¹⁷ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 6.6.2023.

15.7 Sipas analizës financiare në pikën 13 të këtij vendimi, rezultoi se nëna e subjektit kishte mundësi financiare për krijimin e depozitës bankare në vlerën 1,042,875 lekë, që ka shërbyer më vonë për huan e dhënë në vlerën 1,200,000 lekë vajzës V.B, në vitin 2013.

Në përfundim të hetimit, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me këto marrëdhënie huaje.

Deklarimi i pasurive të motrës së subjektit, S.B

16. Llogari në Bank of America në emër të motrës S.B

16.1 Në deklaratën *Vetting*, motra e subjektit ka deklaruar llogari në USD në Bank of America Detroit, Michigan USA, çelur në shtator të vitit 2016 dhe me gjendje në datën 13.12.2016, në vlerën 702.71 USD.

Burimi i krijimit nga huaja marrë nënës dhe babait dhe kursime ndër vite nga paga personale. Zotërimi 100%.

16.2 Subjekti është pyetur lidhur me konfirmimin e kësaj gjendjeje bankare të deklaruar në deklaratën *Vetting*, e cila në përgjigje të pyetësorit nr. *** ka deklaruar: *“Llogaria bankare e znj. S.B në Bank of America, me numër *** ***, është hapur në fillim të muajit shtator 2016 dhe është mbyllur në datën 5 janar 2018. Për shkak të kohës së largët nuk disponon statement të llogarisë për vitin 2016 (përveçse një kopje balance të gjendjes së llogarisë 12-15 dhjetor 2016 bashkëlidhur).¹⁸ ...Nga komunikimi që znj. S.B ka pasur me bankën ditën që më kanë mbërritur pyetjet e organit tuaj, është vënë në dijeni se të dhënat e llogarisë bankare në SHBA ruhen deri në 7 vite nga hapja e llogarisë, prandaj statementi për vitin 2016 nuk mund t'i vihet në dispozicion nga Bank of America”.*

16.3 Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti, duket që gjendja e llogarisë tek Bank of America deri në datën 15.12.2016 është në shumën 13,329.48 USD. Prandaj, në mungesë të ndonjë dokumenti tjetër, në analizën financiare kjo është përdorur si balancë e fundvitit për këtë llogari.

16.4 Në përgjigje të pyetësorit ***, subjekti ka bashkëlidhur edhe kopje të disa çeqeve të lëshuara nga E.B. F, INC, me përfituese S.B, sipas të cilave duket se ky fondacion i ka akorduar kësaj shtetaseje shumat 13,167 USD, me datë 15.12.2016, në total 19,167 USD në vitin 2017.

16.5 Vlera e llogarisë në datën 15.12.2016, në shumën 13,329.48 USD, e përfshin edhe vlerën hyrëse të çekut të parë nga E. B. F, INC, të lëshuar në emrin e motrës së subjektit në të njëjtën datë.

Sa më sipër, Komisioni nuk krijoi dyshime lidhur me burimin e krijimit të këtij likuiditeti bankar në shumën 13,327 USD.

17. Gjendje cash në vlerën 3,800 USD

17.1 Në deklaratën *Vetting*, motra e subjektit ka deklaruar se në datën 13.12.2016 ka disponuar gjendje *cash* në vlerën 3,800 USD, me burim krijimi nga huaja e marrë nënës dhe babait dhe kursimet ndër vite nga paga personale. Zotërimi 100%.

17.2 Lidhur me mundësitë financiare të motrës së subjektit për krijimin e gjendjes *cash* në periudhën 3.11.2014 – 31.12.2016, referojuni analizës financiare në pikën 22 të këtij vendimi.

¹⁸ Shih dokumentacionin bashkëlidhur, kopje balancë llogarie 12-15 dhjetor 2016, *email* zyrtar i Bank of America për hapje dhe përdorim llogarie, si dhe për dërgim kartë debiti, *statement* bankar 11.10.2017 – 5.1.2018.

18. Dy llogari bankare në Intesa Sanpaolo Bank dhe BKT

- a) Llogari në Intesa Sanpaolo Bank, vlera 5 euro;
- b) Llogari në BKT, vlera 8,954 lekë.

18.1 Në deklaratën *Vetting*, motra e subjektit ka deklaruar se disponon llogari në euro në Intesa Sanpaolo Bank, me gjendje të mbetur vlerë e papërfillshme, me burimi krijimi dhuratë nga nëna dhe kursime nga paga ndër vite, si dhe llogari rrjedhëse në BKT, me burim krijimi të ardhura nga paga në ILDKPKI.

18.2 Intesa Sanpaolo Bank¹⁹ ka konfirmuar llogari në emër të shtetasës S.B , me gjendje në datën 20.1.2017, në vlerën 3,56 euro, të hapur në prill të vitit 2010 me një depozitë në shumën 50 euro, dhe më pas ka veprime me vlera të vogla gjatë viteve.

18.3 BKT-ja²⁰ ka konfirmuar llogari në emër të shtetasës S.B , me gjendje në datën 20.1.2017, në vlerën 7,193.03 lekë dhe në *statement*-in bankar të llogarisë, të hapur në tetor të vitit 2014 si llogari page.

18.4 Ka një mospërputhje të papërfillshme mes gjendjes bankare të deklaruar nga shtetasja S.B (8,954 lekë) me gjendjen e datës së deklaratës (7,193 lekë), por që kuptohet se ka ndodhur thjesht për shkak të ndryshimit të datës së balancës.

Në lidhje me këto dy llogari bankare, Komisionit nuk i rezultuan problematika.

19. Fond pensioni S në emër të motrës S.B

19.1 Shtetasja S.B në deklaratën *Vetting* deklaroi: *“Blerë kuota sigurimi pensioni vullnetar pranë subjektit “S Pension” në shumën 20,274 lekë. Çelur në vitin 2013 me burim të ardhura nga paga. Vlera: 20,274 lekë. Zotërimi 100%”*.

19.2 Credins Invest me shkresën nr. *** prot., datë 17.7.2017, konfirmon se shtetasja S.B është kliente prej datës 6.6.2016. Kontributet e derdhura në emër të kësaj shtetaseje kanë kaluar në llogari nga paga e shtetasës V.B , në cilësinë e të afërmit. Sipas certifikatës së pronësisë: shuma totale 21,624.23 lekë.

19.3 Credins Invest²¹ ka konfirmuar se shtetasja S.B është kliente prej datës 5.2.2013. Kontributet e derdhura në emër të znj. Aulona Bodo kanë kaluar në llogari nga paga e shtetasës V.B , në cilësinë e të afërmit. Sipas të dhënave të dërguara përmes shkresave nga Credins Invest, shuma totale në datën 31.12.2016 ishte 21,188.36 lekë.

19.4 Referuar rezultatit pozitiv financiar të gjithë periudhës së krijimit të këtij investimi nga ana e subjektit dhe familjarëve të saj që para fillimit të detyrës²², kur ka ndodhur blerja e të gjitha kuotave të zotëruara, rezultoi se motra e subjektit kishte mundësi financiare për blerjen e tyre.

¹⁹ Shihni shkresat nr. *** prot., datë 11.7.2017 dhe nr. *** prot., datë 12.6.2023.

²⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 17.7.2017 dhe nr. *** prot., datë 23.5.2023.

²¹ Me shkresat nr. *** prot., datë 17.7.2017 dhe nr. *** prot., datë 26.5.2023.

²² Shihni analizën financiare në pikën 1 të këtij vendimi.

20. Set diamantesh “**” dhe orë “****”**

20.1 Në deklaratën *Vetting*, motra e subjektit ka deklaruar:

- ✓ Set diamantesh të markës “****” me vlerë 2,000 USD, dhuruar nga të afërm në vitin 2011;
- ✓ Orë e markës “****” me vlerë 1,200 euro, dhuruar nga të afërm në vitin 2012. Zotërimi 100%.

Sa më sipër, Komisioni nuk i bëri pjesë të analizës financiare këto sende me vlerë për shkak të vlerës së tyre.

21. Shpenzimet e studimit të shtetases S.B në SHBA

21.1 Në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti ka deklaruar: *“Nuk ka pasur shpenzime për jetesën, pasi motra ime S.B është mirëpritur për të jetuar gjatë gjithë periudhës së studimit në USA nga shtetasi amerikan F.F, kushëriri im i parë (djali i dajës)”*.

21.2 Bashkëlidhur përgjigjes së pyetësorit, subjekti ka sjellë kopje të pasaportës së shtetasit amerikan F.F , deklaratën e këtij shtetasit të datës 21.12.2021, në të cilën ai deklaron se kushërira e tij S.B gjatë periudhës së studimeve pasuniversitare në SHBA (2016 – 2018) është mirëpritur për të jetuar në shtëpinë e tij të banimit në Michigan, SHBA, si dhe kopje të deklaratave tatimore për të ardhurat e këtij shtetasi për vitet 2018, 2019 dhe 2020.

21.3 Sa më sipër, nuk janë llogaritur shpenzime jetese për motrën e subjektit S.B për periudhën e studimeve në SHBA.

21.4 Në përgjigje të pyetësorit ***, e pyetur për shpenzimet e studimit të motrës S.B në SHBA për vitin 2016, subjekti deklaron: *“Bashkëlidhur fatura *** (method cash payment) datë 31.8.2016, në shumën 10,217 USD, për semestrin e parë gusht-dhjetor 2016. Burimi nga kursimet personale dhe huaja në shumën 900,000 lekë dhe 1,000 USD nga dy prindërit e mi, M dhe N.B”*.

21.5 Kjo vlerë e vërtetuar me dokumentacion është përfshirë si shpenzim në analizën financiare.

22. Analiza financiare

22.1 Analiza financiare është kryer nga Komisioni për periudhën nga fillimi i detyrës së subjektit (3.11.2014) deri në datën 31.12.2016. Kjo analizë përfshin pasuritë (likuiditetet bankare dhe *cash*²³), të ardhurat, shpenzimet dhe shlyerjet e detyrimeve për subjektin e rivlerësimit dhe familjarët e saj, me të cilët ajo ka bashkëjetuar dhe ka qenë në një certifikatë familjare.

22.2 Nga analiza financiare rezultoi se subjekti dhe familjarët e saj kishin një pamundësi financiare për shtimin e pasurive (likuiditeteve) dhe mbulimin e shpenzimeve prej -298,072 lekësh, për periudhën 3.11.2014 – 2016.

22.3 Për sa më sipër, subjektit të rivlerësimit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet dhe paraqitur provat e saj për të provuar të kundërtën e konstatimeve të bëra nga ana e Komisionit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

²³ Për vitet 2014 dhe 2015 nuk përfshihen kursimet *cash* të prindërve dhe motrës së subjektit në analizën financiare, për shkak se ato nuk e kanë pasur detyrimin për deklarim në deklaratimet periodike vjetore.

22.4 Në përgjigje të rezultateve të hetimit subjekti ka prapësuar si vijon: *“Pavarësisht rezultatit të analizës financiare me bilanc pozitiv, në raportin përfundimtar, Komisioni ka konkluduar se ka një balancë negative në vlerën prej 298,072 lekësh në vitin 2016, duke konkluduar se subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e saj kanë qenë në pamundësi financiare për të krijuar shtesë të likuiditeteve në masën e sipërcituar.*

Në lidhje me analizën financiare, konstatoj se nuk është përfshirë në këtë analizë mundësia për kursim e prindërve të mi si para detyre, por edhe pas detyrës. Kanë qenë pikërisht të ardhurat që i janë dhënë hua motrës time S.B në vlerën 900,000 lekë dhe 1,000 USD për shpenzimet e shkollimit në USA. Në lidhje me këtë hua, në cilësinë e subjektit deklarues, nuk kam pasur detyrimin për ta deklaruar në deklaratat periodike vjetore.

Prindërit e mi nuk kanë pasur detyrimin ligjor për të deklaruar në deklaratat periodike vjetore. Analiza e likuiditeteve në cash e subjekteve deklaruese nuk mund të përdoret për subjekte që nuk kanë pasur detyrimin për deklarim, siç janë personat e lidhur të konsideruar të tillë vetëm nga ligji nr. 84/2016.

Kolegji²⁴ ka konsideruar të drejtë që analiza për familjen e subjektit të bëhet duke përllogaritur mundësinë për kursim të prindërve të personit të lidhur deri në fund të vitit 2016 para plotësimit të deklaratës së pasurisë Vetting...

Bazuar në këtë arsyetim, kërkoj nga Komisioni që në analizën financiare të përfshijë edhe mundësinë për kursim në shumën totale 6,663,714 lekë, e llogaritur nga Komisioni në tabelën Excel me emërtimin “3.11.14 – 31.12.16 (FAM)”.

22.5 Në vazhdim, subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me mënyrën e përllogaritjeve të kryera për vitin 2016 për ndryshimin në likuiditet të pasqyruara në tabelën e sjellë prej saj në këto prapësime. Sipas këtyre përllogaritjeve, subjekti dhe familjarët e saj rezultojnë me balancë pozitive për vitin 2016, duke pretenduar një rezultat financiar në koherencë me Komisionin.

Vlerësimi i Komisionit

22.6 Në analizën e përcjellë tek subjekti në rezultatet e hetimit, nuk ishin përfshirë kursimet familjare para fillimit të detyrës, për sa kohë familjarët e saj nuk kishin deklaruar në deklaratat periodike, referuar përcaktimeve të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” dhe nuk e kanë pasur detyrimin ligjor për të deklaruar në deklaratat periodike vjetore²⁵.

22.7 Referuar analizës financiare para fillimit të detyrës të hartuar për subjektin dhe familjarët e saj²⁶, kjo familje rezultoi me një tepicë pozitive në vlerën 8,611,743 lekë. Po të përfshihen këto kursime në analizën financiare të periudhës 3.11.2014 – 31.12.2016, do të eliminohet krejtësisht pamundësia financiare në vlerën -298,072 lekë. Prandaj, Komisioni vlerësoi përfshirjen e këtyre kursimeve në analizën financiare, çka solli edhe përmbysjen e pamundësisë financiare, për të cilën subjektit iu kalua barra e provës në rezultatet e hetimit.

22.8 Sa më sipër, referuar shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe ligjit të sipërcituar, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti dhe familjarët e saj kishin mundësi financiare për

²⁴ Shihni vendimin nr. 26, datë 3.7.2023.

²⁵ Prindërit dhe motra e subjektit nuk kanë deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës dhe në DPV-në e viteve 2014, 2015 dhe 2016. Ata kanë deklaruar për herë të parë në deklaratën e pasurisë (deklarata Vetting) të datës 20.1.2017.

²⁶ Shihni pikën 1 të këtij vendimi.

krijimin e pasurive (likuiditeteve) dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera për periudhën 3.11.2014 – 31.12.2016.

23. METODOLOGJIA

Gjatë kësaj analize, Komisioni është bazuar në:

a. Gjendjet e likuiditeteve të subjektit, prindërve dhe motrës S.B , të nxjerra nga dokumentet bankare të kërkuara nga: BKT, Raiffeisen Bank, Credins Bank, Tirana Bank, ish-Emporiki Bank, ABI Bank, Intesa Sanpaolo Bank, Alpha Bank, Union Bank, SiCRED, Bank of America, si dhe gjendjet *cash* të deklaruara nga subjekti dhe familjarët e saj.

b. Të ardhurat e ligjshme, ku përfshihen:

i) Të ardhurat e subjektit nga paga pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (2004 – 2006), pranë A sh.a. (2006 – 2007), pranë U.T (2007), tek Agjencia e Trajtimit të Pronave (2008 – 2012), Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (2013 – 2014), pjesë e Task Forcë - eksperte tek Kryeministria (2014), si ndihmëse ligjore tek Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë (2014 – 2016).

ii) Të ardhurat e babait të subjektit nga paga si mësues tek shkolla 9-vjeçare “****”, Tiranë (1994 – 2002) dhe nga pensioni i pleqërisë, asistencë + shpërblime (2002 – 2016).

iii) Të ardhurat e nënës së subjektit nga paga si inspektore tek Ministria e Drejtësisë (1994 – 2004) nga ekzekutimi i vendimit të Gjykatës së Apelit nr. ***, datë 5.10.2004 (2004 – 2006) nga pensioni i pleqërisë dhe pensioni suplementar + asistencë + shpërblime (2006 – 2016).

iv) Të ardhura nga aktiviteti privat i nënës së subjektit (17.10.2007 – 30.4.2009) sipas vlerës së deklaruar nga ajo në deklaratën *Vetting* dhe referuar vërtetimit të Bashkisë Tiranë për qarkullim të deklaruar në vlerat 0-2 milionë në vit.

Në analizën financiare nuk janë përfshirë të ardhurat e pretenduara prej nënës së subjektit nga ushtrimi i profesionit të avokates për periudhat 1990 – 1994 dhe 18.3.2004 – janar 2006, për arsye se këto të ardhura nuk janë vërtetuar me dokumente justifikuese ligjore.

v) Të ardhurat e motrës së subjektit S.B nga paga si këshilltare ligjore pranë KQZ-së (2011), juriste pranë Union Bank (2012 – 2013), specialiste pranë ILDKPKI-së (2014 – 2016) sipas vërtetimit nga ISSH-ja me nr. *** prot., datë 25.5.2023 dhe *statement* bankar të llogarive në emër të saj pranë Tirana Bank, Union Bank dhe BKT.

vi) Të ardhurat e motrës nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor të Gjykatës së Apelit Tiranë nr. ***, datë 2.7.2015, për largim nga puna nga Union Bank, ekzekutuar pranë BKT-së (2015).

vii) Të ardhurat e motrës nga çek i lëshuar nga Fondacioni E.B në SHBA (15.12.2016).

viii) Të ardhura nga interesat e depozitave ndër vite të subjektit dhe prindërve të saj (2006 – 2016).

Të ardhurat e pretenduara nga subjekti për konsulencë të dhënë në rrugë private, në vlerën 500,000 lekë para fillimit të detyrës, nuk janë përfshirë si të ardhura të ligjshme në analizën financiare, për sa kohë nuk është vërtetuar realizimi i tyre dhe pagesa e detyrimeve tatimore përkatëse.

c. Shpenzimet, ku përfshihen:

i) Shpenzimet e jetesës, bazuar në shpenzimet mujore për konsum sipas madhësisë së familjes (në shpenzimet e përcaktuara nga ILDKPKI-ja sipas INSTAT-it) për periudhën 2000 – 2016. Për periudhën para vitit 2000 janë llogaritur shpenzime jetese në masën 66% të të ardhurave bruto nga punësimi.

ii) Shpenzime për tatimin nga shitja e pasurive të paluajtshme (1996, 2001), si dhe shpenzim për rivlerësimin e pasurisë në rrugën “***” (2013) sipas ligjit në fuqi të kohës.

iii) Shpenzime mjekësore, sipas deklarimit të subjektit në përgjigje të pyetësorit për nënën (2014) dhe për babain (2016).

iv) Shpenzime mobilimi, sipas deklarimit të subjektit në përgjigje pyetësori (2014).

v) Shpenzime për tatimin nga shitja e pasurive të paluajtshme (1999, 2000, 2012, 2015).

vi) Shpenzime udhëtimi për të cilat janë marrë të dhëna nga sistemi TIMS. Për përlllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit është zbatuar vendimi nr. 11/2019 (JR), i datës 22.5.2019, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet e udhëtimit kur subjekti/bashkëshorti/ja kanë deklaruar e dokumentuar udhëtime për qëllime pune dhe ato për të cilat është dokumentuar qëndrim pranë njerëzve të afërm.

vii) Shpenzime për studimet e motrës S.B (2016) sipas dokumentit të sjellë nga W. U, Michigan, USA.

d. Në vlerat e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, bazuar në kontratat e sipërmarrjeve/shitblerjeve të këtyre pasurive²⁷.

e. Në vlerat e huas së dhënë motrës V.B (M) në vitin 2013 nga subjekti dhe nga nëna e saj, N.B, si dhe huave të dhëna brenda familjes nga babai dhe nëna e subjektit tek motra S.B për studime (2016).

Në lidhje me konfliktin e interesit

24. Komisioni hetoi lidhur me konfliktin e mundshëm të interesit të subjektit të rivlerësimit bazuar në informacionin e kërkuar²⁸ Gjykatës së Lartë, për të provuar nëse znj. Aulona Bodo në cilësinë e ndihmëses ligjore ka dhënë/përgatitur relacione/opinione ligjore për periudhën 2014 – 2024, për çështje me palë shtetasit M.B , I.B dhe S.B , të cilat janë gjykuar nga kjo Gjykatë.

25. Gjykata e Lartë ka informuar²⁹ se këshilltarja Aulona Bodo për periudhën 2014 – 2024 nuk rezulton të ketë dhënë/përgatitur relacione/opinione ligjore për çështje me palë ndërgjyqëse shtetasit M.B , I.B dhe S.B .

Konkluzion i Komisionit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit

26. Komisioni, në vlerësimin e çështjes në lidhje me kriterin e pasurisë, çmoi se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të saktë dhe të mjaftueshëm për pasuritë e krijuara, sipas përcaktimeve të shkronjës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

²⁷ Shihni kontratat e shitjeve për pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁸ Me kërkesën me lëndë “Kërkesë për informacion”, me nr. *** prot., datë 21.5.2024.

²⁹ Me shkresën me lëndë “Dhënie informacioni”, me nr. *** prot., datë 27.5.2024.

B. KONTROLLI I FIGURËS

1. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.

2. Për këtë qëllim, AKSIK-ja në zbatim të kërkesave të nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pas përfundimit të procedurave të kryera³⁰ nga Grupi i Punës për kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit Aulona M. Bodo , me detyrë këshilltare ligjore, ka dërguar³¹ raportin nr. *** prot., datë 2.11.2017, të deklasifikuar pjesërisht³².

3. Sipas këtij raporti u konstatua se:

- *Formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 84/2016.*

- *Subjekti i rivlerësimit ka vetëdeklaruar në pjesën 5 “Të dhëna për sigurinë”, të deklaratës për kontrollin e figurës, për pyetjen e përcaktuar në shkronjën “b”, se ka dijeni për dy familjarë të saj, konkretisht “shtetasit *** dhe *** që janë proceduar penalisht për veprën penale të parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal dhe se çështja është pushuar ndaj tyre me vendim të organit të akuzës”.*

- *Informacionet nga institucionet e verifikimit pohojnë se znj. Aulona M. Bodo ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ajo në deklaratën për kontrollin e figurës.*

- *Nga institucionet verifikuese konfirmohet vetëdeklarimi i bërë nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me shkronjën “b” të pjesës 5 “Të dhëna për sigurinë”, të deklaratës për kontrollin e figurës dhe se “shtetasit *** dhe *** disponojnë të dhëna që i implikojnë në veprimtari të kundërligjshme në formën e kultivimit/magazinimit/trafikimit të lëndëve narkotike, të viteve 2016 e 2017.*

- *Por, gjithashtu, bazuar në informacionet e autoriteteve verifikuese, nuk rezulton të ketë pasur kontakte të papërshtatshme, në papajtueshmëri me detyrën e subjektit të rivlerësimit, me lidhjet e saj familjare, persona të njohur dhe të përfshirë në krimin e organizuar, veprimtari e publikuar dhe e dokumentuar sipas kërkesave të shkronjës “d”, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.*

- *Nisur nga informacionet e autoriteteve verifikuese dhe deklaratës për kontrollin e figurës gjykojmë se ndodhemi para “rrethanave lehtësuese, që merren parasysh në konstatimin e faktit se ekziston një kontakt i papërshtatshëm më një person të përfshirë në krimin e organizuar” sipas kërkesave të parashikuara në shkronjën “c”, pika 5 e nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilave subjekti i rivlerësimit ka qenë i hapur dhe i besueshëm në vetëdeklarimin e dhënë dhe që marrëdhënia apo kontaktet familjare me persona të përfshirë në krimin e organizuar kanë qenë të rralla dhe është distancuar prej tyre.*

³⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 4.3.2024, i është kërkuar AKSIK-së përditësimi dhe deklasifikimi i raportit të figurës së subjektit.

³¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 13.5.2024.

³² Me vendimin e KDZH-së nr. ***, datë 9.5.2024.

- Për subjektin Aulona Bodo nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për implikimin e saj ose/apo për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

Sa më sipër, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, znj. Aulona M. Bodo .

4. Pavarësisht nga raporti i dërguar nga AKSIK-ja, ku konstatohet përshtatshmëria për vazhdimin e detyrës së subjektit, Komisioni ka kryer hetim administrativ në lidhje me një informacion, nga i cili ngrihej dyshimi për kontakt të papërshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Komisioni iu drejtua³³ Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), me kërkesën për informim nëse është ushtruar ndjekje penale apo janë proceduar penalisht shtetasit B.B , V.B.B dhe D (D) M.B.

5. SPAK ka informuar³⁴ pas verifikimeve të kryera në emër të këtyre shtetasve.

6. Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka vetëdeklaruar në deklaratën për kontrollin e figurës nëse ka pasur dijeni që shtetasi B . B të jetë proceduar penalisht për ndonjë vepër penale.

7. Sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të shpjegojë dhe të provojë me dokumentacion ligjor se nuk ka pasur detyrimin ligjor të deklarimit si kontakt për shtetasin B.B.

8. Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar se: *“Në lidhje me shtetasin B.B.B, ai është djali i vogël i xhaxhait tim B.B dhe vëllai i shtetasit V.B. Në lidhje me procedimin penal të mësipërm, shtetasi B.B nuk është ndjekur penalisht nga ana e organit të akuzës apo të jetë arrestuar dhe vendosur në kushtet e ndalimit personal, në paraburgim. Në këto kushte, nuk kisha si të mund të bëja deklarinimin e emrit të tij në lidhje me këtë çështje, sikundër e kam bërë për dy djemtë e tjerë të xhaxhallarëve.*

Në cilësinë e këshilltarit ligjor të Gjykatës së Lartë, e caktuar si pjesë e grupit të këshilltarëve ligjorë që asistojnë dhe ndihmojnë organin kushtetues të pavarur, këshillin e emërimeve në drejtësi për të bërë verifikimin e kontrollit të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale të kandidatëve që aplikojnë për të kandiduar si anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, jam pajisur në vitin 2021 me certifikatë të sigurimit të personelit për njohje me informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”. Në këtë mënyrë vërtetohet fakti se plotësoj kriteret e pastërtisë së figurës tej çdo dyshimi të arsyeshëm”.

Konkluzion i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

9. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni për subjektin Aulona Bodo, si dhe referuar shpjegimeve të saj në përgjigje të rezultateve të hetimit, u arrit në konkluzionin se për subjektin e rivlerësimit Aulona Bodo nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Deklarimet e subjektit kanë rezultuar të sakta dhe të vërteta.

³³ Me shkresën nr. *** prot., datë 21.5.2024.

³⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 5.6.2024.

Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit Aulona Bodo ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI AFTËSIVE PROFESIONALE

1. Ky raport është përgatitur bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Raporti i ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet duke iu referuar kritereve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;
- c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale;
- ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

3. Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- i) formularit të vetëdeklarimit, të 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- ii) 5 dokumenteve ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- iii) të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.

4. Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit, konstatohet se formulari është plotësuar sipas formës standarde, në mënyrë të plotë, me faqe të nënshkuara rregullisht, pa mangësi nga pikëpamja formale.

5. Subjekti i deklarimit, znj. Aulona Bodo, ka deklaruar se ushtron funksionin e ndihmëses ligjore në Gjykatën e Lartë nga data 3 nëntor 2014 dhe aktualisht.

6. Lidhur me të dhënat sasiore, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se si ndihmëse ligjore pranë Gjykatës së Lartë, në periudhën 3.11.2014 – 8.10.2016, i janë caktuar për shqyrtim 35 dosje gjyqësore në vitin 2014, 304 dosje në vitin 2015 dhe 267 dosje gjyqësore në vitin 2016.

7. Subjekti i rivlerësimit Aulona Bodo ka deklaruar se:

- ✓ Numri i çështjeve të përfunduara për vitin 2014 është 35, nga të cilat 19 çështje themeli, 9 çështje kompetence, 1 çështje juridiksioni dhe 6 pezullime;
- ✓ Numri i çështjeve të përfunduara për vitin 2015 është 303, nga të cilat 230 çështje themeli, 27 çështje kompetence, 12 çështje juridiksioni dhe 35 pezullime;
- ✓ Numri i çështjeve të përfunduara për vitin 2016 është 255, nga të cilat 200 çështje themeli, 18 çështje kompetence, 4 çështje juridiksioni, 1 çështje përjashtim gjyqtari dhe 32 pezullime;

8. Subjekti i rivlerësimit Aulona Bodo nuk hyn në kategorinë e subjekteve që kanë detyrimin ligjor të frekuentojnë trajnimet e organizuara nga Shkolla e Magjistraturës. Për pasojë, ajo nuk ka deklaruar trajnime të kryera pranë Shkollës së Magjistraturës.

Tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Dokumenti 1. Relacion për çështjen administrative që i përket paditësit G. B. kundër të paditurit komuna Gj, me objekt “Dëmshpërblim për largim të padrejtë nga puna etj.” Ndhmësja ligjore ka arsyetuar se: *“Të dyja gjykatat më të ulëta kanë respektuar normat procedurale të gjykimit për të pasur një proces të rregullt ligjor. Ato nuk kanë kryer një hetim të plotë e të gjithanshëm për t’u dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura nga palët në proces, si dhe nuk kanë arsyetuar qartë dhe nuk kanë evidentuar se në cilat prova janë mbështetur kur kanë konkluduar se zgjidhja e marrëdhënies së punës është kryer në mënyrë të menjëhershme dhe për shkaqe të justifikuara. Të dyja gjykatat iu referohen akteve të kryera në vitin 2007 dhe 2008, si dhe akteve të krijuara pas zgjidhjes së kontratës së punës, e konkretisht atyre të datës 27.9.2010 dhe 9.7.2010, kur zgjidhja e marrëdhënies së punës së palës paditëse është kryer në datën 8.4.2010”.*

Në përfundim, ndihmësja ligjore ka sugjeruar për Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë se çështja duhet të rikthehet për rishqyrtim, për t’u kryer një hetim i plotë dhe i gjithanshëm, si dhe për t’i dhënë zgjidhje përfundimtare çështjes në përputhje me dispozitat ligjore të zbatueshme.

Relacioni i hartuar nga znj. Aulona Bodo është i plotë dhe i saktë. Ai përmban elementet e parashikuara në nenin 21 të ligjit nr. 8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe në nenin 25 të Rregullores së Brendshme të Gjykatës së Lartë, të miratuar me urdhrin nr. ***, datë 12.9.2014, të kryetarit të kësaj Gjykate. Ajo ka relatuar mosmarrëveshjen objekt gjykimi, ka cituar në mënyrë të sintetizuar disponimet dhe arsyetimet e gjykatave të faktit, ka analizuar ligjërisht shkaqet e rekursit, si dhe ka paraqitur propozim konkret për zgjidhjen e çështjes nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.

Dokumenti 2. Relacion për çështjen administrative që i përket paditësit I. A. kundër të paditurit ZQRPP Tiranë, me objekt “Anulimin pjesërisht të vendimit nr. ***, datë 24.4.2010, të kryeregjistruesit të ZQRPP-së Tiranë për heqjen e kufizimit për pasurinë me nr. *** hipotekor, datë 18.12.2009, për sipërfaqen 600 m² truall, si dhe për pasurinë me nr. ***, datë 26.2.2004, për objektin trekatësh, ndërtuar mbi këtë truall, me sipërfaqe 288 m²”.

Relacioni i hartuar nga znj. Aulona Bodo është i plotë dhe i saktë. Ndhmësja ligjore ka relatuar se rekursi ishte ushtruar brenda afatit ligjor, se u ishte komunikuar rregullisht palëve ndërgjyqëse, se pala që ka ushtruar rekursin legjitimohet ta bëjë atë dhe se çështja hyn në juridiksionin gjyqësor. Ajo ka relatuar mosmarrëveshjen objekt gjykimi, ka cituar në mënyrë të sintetizuar disponimet dhe arsyetimet e gjykatave të faktit (Apeli ka mbajtur të njëjtin arsyetim si Shkalla e Parë), si dhe ka analizuar ligjërisht shkaqet e rekursit.

Ndhmësja ligjore në përfundim nuk ka paraqitur propozim konkret për zgjidhjen e çështjes nga Kolegji Administrativ, por në arsyetim ka lënë të kuptohet se kërkon prishjen e vendimeve të gjykatave më të ulëta, për shkak se sipas vlerësimit të saj këto gjykata nuk kanë kryer një hetim të plotë dhe shterues të çështjes, duke e lënë atë pa një zgjidhje të plotë e përfundimtare.

Dokumenti 3. Relacion për çështjen administrative që i përket paditësit A.S , kundër të paditurit ZVRPP Kavajë, me objekt “Njohjen e pavërtetësisë së fletës së regjistrimit nr. ***, indeksi *** të regjistrimit hipotekor të vitit 1926 – 1927” lidhur me mbiemrin e pronarit të tanishëm nga D. I. G në D. I. S.

Nga studimi i akteve të administruara në dosjen gjyqësore, rezulton se pala paditëse ka kërkuar të deklarojë si të pavërtetë dhe të pasaktë fletën e regjistrimit hipotekor me nr. ***, indeksi ***, të vitit 1926 –1927 lidhur me saktësimin e emrit të pasqyruar në rubrikën “Pronari i tanishëm” nga D. I. G në D. I. S, duke thirrur si palë të paditur ZVRPP-në Kavajë. Si bazë ligjore të kësaj padie paditësi ka përdorur nenin 32, shkronja “c” e Kodit të Procedurës Civile.

Relacioni i hartuar nga znj. Aulona Bodo për çështjen administrative është i plotë dhe i saktë. Ndhmësja ligjore ka relatuar mosmarrëveshjen objekt gjykimi, ka cituar në mënyrë të sintetizuar disponimet dhe arsyetimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, si dhe të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, si dhe ka analizuar ligjërisht kërkimet e padisë, me qëllim sqarimin nëse çështja përbënte mosmarrëveshje administrative, e cila ishte në kompetencë të gjykatave administrative apo ishte mosmarrëveshje civile dhe që duhej gjykuar nga gjykata civile.

Ndhmësja ligjore në përfundim nuk ka paraqitur propozim konkret për zgjidhjen e çështjes nga Kolegji Administrativ, por në arsyetim ka lënë të kuptohet se mosmarrëveshja objekt gjykimi nuk përbën lëndë pune për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, por mosmarrëveshje të mirëfilltë civile, e cila është në kompetencë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë. Kështu, ndihmësja ligjore ka arsyetuar se çështja objekt gjykimi nuk rregullohet nga ligji i posaçëm, ligji nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, pasi në padi nuk kundërshtohet një akt administrativ apo nuk kërkohet kryerja e një veprimi administrativ nga organet e administratës publike, si dhe kjo mosmarrëveshje nuk rregullohet as nga ligji tjetër i posaçëm, ligji nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i cili është ligji që rregullon veprimtarinë e ZVRPP-së si palë e paditur në këtë gjykim.

Përshkrimi i 5 dokumenteve ligjore të vëzhguara, të përzgjedhura me short

Dokumenti 1. Relacion për çështjen administrative që u përket palëve: paditës shoqëria “Y. Y. A.C.D” ltd, kundër të paditurit Bashkia Tiranë, me objekt “Shfuqizimi i pjeshëm i vendimit nr. ***, datë 7.6.2008, pjesërisht vetëm për sa i përket pikave 1, 2 dhe 3 të tij”. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. ***, datë xx.2014, ka vendosur prishjen e vendimit nr. ***, datë xx.2010, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Relacioni i hartuar nga znj. Aulona Bodo pasqyron qartë, saktë dhe plotësisht rrethanat e faktit, qëndrimin e gjykatave të faktit, pretendimet e palëve për mosmarrëveshjen, si dhe çështjet, shkaqet e ngritura në rekurs.

Ndhmësja ligjore ka marrë në analizë nga pikëpamja e ligjit dhe e faktit vendimmarrjen e Gjykatës së Shkallës së Parë, por edhe atë të Gjykatës së Apelit Tiranë, duke vlerësuar të gabuar vendimmarrjen e tyre. Ajo ka çmuar se në vendimin e shkallës së parë vërehet mospërputhje midis pjesës arsyetuese dhe dispozitivit, fakt që e bën atë të cenueshëm, si dhe ka konstatuar se gjykata e faktit ka ngatërruar pavlefshmërinë absolute të aktit me pavlefshmërinë që çon vetëm në anulimin e aktit, por nuk ka zgjidhur pasojat që vijnë nga pavlefshmëria absolute.

Gjithashtu, ndihmësja ligjore vëren se në gjykim duhej të thirrej të paktën si person i tretë nga gjykata edhe një palë, e cila tërheq interesa nga kundërshtimi në gjykatë i lejes së ndërtimit objekt i atij gjykimi, por që nuk është thirrur. Pra, ngrihen probleme edhe lidhur me ndërtimin e ndërgjyqësisë (probleme procedurale).

Konstatohet se propozimi i dhënë nga ndihmësja ligjore Aulona Bodo përputhet plotësisht me vendimin (disponimin) nr. ***, datë 11.12.2014, të dhënë nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.

Vlerësohet se relacioni i përpiluar nga ndihmësja ligjore Aulona Bodo është plotësisht i saktë.

Dokumenti 2. Relacion për çështjen administrative, që u përket palëve: paditëse shoqëria “****” sh.a., kundër të paditurve: 1. Reparti Ushtarak nr. ***, Tiranë; 2. Reparti Ushtarak nr. ***, Tiranë, me objekt “Detyrimin e të paditurve që në zbatim të kontratës nr. ***, datë 22.8.2008, të paguajnë shumën 8,310, 996 lekë, diferencë e papaguar nga kontrata dhe interesat ligjorë në vlerën 9,141,413 lekë në favor të palës paditëse, shoqëria “****” sh.a.

Relacioni pasqyron qartë, saktë dhe plotësisht rrethanat e faktit, qëndrimin e gjykatave të faktit, pretendimet e palëve për mosmarrëveshjen, si dhe çështjet, shkaqet e ngritura në rekurs.

Ndihmësja ligjore ka relatuar se rekursi ishte ushtruar brenda afatit ligjor dhe se u ishte komunikuar palëve ndërgjyqëse. Ajo ka marrë në analizë pretendimet e ngritura në rekurs nga pala e paditur për shkelje procedurale të kryera nga Gjykata e Apelit, që lidhet me mosnjohimin e palës së paditur për datën dhe orën e seancës gjyqësore, duke e vlerësuar si të pabazuar në ligj dhe në prova.

Ndihmësja ligjore ka marrë në analizë pretendimin e palës së paditur se nuk i është komunikuar kundërankimi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe e ka vlerësuar të bazuar këtë pretendim.

Subjekti i rivlerësimit ka marrë në shqyrtim pretendimin e palës së paditur në rekurs, sipas të cilit Gjykata e Apelit e ka shqyrtuar çështjen në kundërshtim me parashikimin e nenit 176 të Kodit të Procedurës Civile dhe e ka vlerësuar atë të pabazuar. Në dhënien e mendimit për këtë pretendim, ndihmësja ligjore i është referuar edhe vendimit unifikues nr. 3, datë 29.3.2012, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Ndihmësja ligjore ka dhënë mendim edhe lidhur me provat e reja të bashkëlidhura rekursit, por që nuk rezultojnë të jenë paraqitur para gjykatave të faktit.

Ndihmësja ligjore ka analizuar edhe zgjidhjen në themel të çështjes nga gjykata e faktit, duke e vlerësuar atë të drejtë e ligjore.

Konstatohet se propozimi i dhënë nga ndihmësja ligjore Aulona Bodo nuk përputhet me vendimin (disponimin) e dhënë nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e ka konsideruar të gabuar zgjidhjen në themel të çështjes nga gjykatat e faktit, si dhe ka vlerësuar se ato kanë konsumuar shkelje procedurale, pasi nuk kanë kryer një hetim të thellë e të gjithanshëm në përputhje me parashikimet e nenit 16 të Kodit të Procedurës Civile. Kolegji prishi vendimet e gjykatave të faktit dhe e dërgoi çështjen për gjykim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

Vlerësohet se relacioni i përpiluar nga ndihmësja ligjore, znj. Aulona Bodo, është i saktë nga pikëpamja formale, pavarësisht se mendimi i dhënë prej saj nuk përputhet me vendimmarrjen e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

E rëndësishme është që ndihmësi ligjor të paraqesë saktë rrethanat e faktit, pretendimet e ngritura në rekurs, të analizojë nga pikëpamja e ligjit shkaqet e ngritura në rekurs apo kundërrkurs sipas rastit, të analizojë ligjërisht zbatimin e ligjit material e procedural nga

gjkatat e faktit etj. Jo në çdo rast mendimi i ndihmësit ligjor mund të përputhet me vendimmarrjen e Kolegjit përkatës të Gjykatës së Lartë.

Kolegji i Gjykatës së Lartë nuk është i detyruar të marrë patjetër në konsideratë mendimin e ndihmësit ligjor për mënyrën e zgjidhjes së çështjes, pasi ndihmësi është vetëm strukturë këshillimore, që asiston gjyqtarët e Gjykatës së Lartë.

Dokumenti 3. Relacion për çështjen administrative, që u përket palëve: paditës K.S. kundër të paditurit Q.E.Zh.E.F Tiranë, me objekt “Detyrimin e palës së paditur të më paguajë dëmshpërblimin 1 vit pagë, shpërblimin për vjetërsi në punë, si dhe çdo shpërblim tjetër që rrjedh nga mosrespektimi i procedurave të zgjidhjes së kontratës së punës”.

Ndihmësja ligjore ka pasqyruar qartë, saktë dhe plotësisht rrethanat e faktit, qëndrimin e gjykatare të faktit, pretendimet e palëve për mosmarrëveshjen, si dhe çështjet, shkaqet e ngritura në rekurs. Ajo u ka dhënë përgjigje pretendimeve në rekurs të palës paditëse për shkelje procedurale të kryera nga Gjykata e Apelit Tiranë, duke i vlerësuar ato si të pabazuara ligjërisht.

Ndihmësja ligjore ka evidentuar se rekursi i palës paditëse ka rënë në dekadencë, ashtu sikurse edhe ankimi ndaj vendimit të shkallës së parë të gjykimit ishte kryer në shkelje të afatit ligjor të caktuar.

Ndihmësja ligjore ka sugjeruar për Kolegjin marrjen në shqyrtim vetëm të pretendimeve të ngritura në rekurs nga pala e paditur, pasi ka analizuar se rekursi i palës paditëse ka rënë në dekadencë, ashtu sikurse edhe ankimi ndaj vendimit të shkallës së parë të gjykimit ishte kryer në shkelje të afatit ligjor të caktuar.

Konstatohet se propozimi i dhënë nga ndihmësja ligjore Aulona Bodo përputhet me vendimin (disponimin) nr. ***, datë 21.1.2016, të dhënë nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë. Relacioni i përpiluar nga ndihmësja ligjore Aulona Bodo është i saktë.

Dokumenti 4. Relacion për çështjen administrative që i përket paditësit shoqëria “***” sh.a., kundër të paditurve: 1. Drejtoria Rajonale Tatimore, njësia e tatimpaguesve të mëdhenj Tiranë; 2. Drejtoria e Apelit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë, me objekt “Shfuqizimin e aktit administrativ, njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr. *** prot., datë 27.1.2011, të nxjerrë nga Drejtoria Rajonale Tatimore, njësia e tatimpaguesve të mëdhenj. Shfuqizimin e aktit administrativ, vendimit nr. ***, datë 30.5.2011, të Drejtorisë së Apelit Tatimor”.

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, referuar akteve shkresore të administruara në dosje, pretendimeve të palëve në proces, si dhe dispozitave ligjore të zbatueshme në mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi, vlerëson se për sa kohë pala paditëse nuk ka pasur të instaluar pajisjen fiskale, si dhe nuk ka qenë e pajisur me numër NIPT-i sekondar në një degë të saj, kjo palë ka kryer kundërvajtje administrative, dhe në kuptim të neneve 112 e 122, shkronja “a” e ligjit nr. 9920/2008, me të drejtë organet tatimore e kanë gjobitur atë në raport me shkeljen e kryer.

Për sa i përket trajtimit në themel të çështjes, të dyja gjykatat kanë vlerësuar se veprimet financiare të subjekteve tatimore, sikundër janë shoqëritë që ushtrojnë veprimtari në fushën e sigurimeve dhe risigurimeve, duhet t’i kryejnë ato nëpërmjet bankës dhe, për këtë arsye, nuk e kanë të detyrueshëm instalimin dhe mbajtjen e kasave fiskale.

Aktualisht kemi një praktikë të konsoliduar nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në lidhje me zgjidhjen e këtyre rasteve, duke u vendosur në kushtet kur këto shoqëri nuk provojnë

se për shërbimet që kanë ofruar pagesën e kanë marrë nëpërmjet bankës, kanë detyrimin ligjor që të instalojnë kasën fiskale sipas parashikimeve të nenit 55 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ndihmësja ligjore ka pasqyruar qartë, saktë dhe plotësisht rrethanat e faktit, qëndrimin e gjykatave të faktit, pretendimet e palëve për mosmarrëveshjen, si dhe çështjet, shkaqet e ngritura në rekurs. Ajo ka identifikuar saktë legjislacionin e zbatueshëm për zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje administrative.

Ndihmësja ligjore ka analizuar zgjidhjen në themel të çështjes nga gjykatat e faktit, me pasojë respektimin e ligjit material nga ana e tyre në zgjidhjen e çështjes. Në këtë kontekst, ndihmësja ligjore evidenton qartë detyrimin që buronte për palën paditëse sipas parashikimit të nenit 55 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Vlerësohet se relacioni i përpiluar nga ndihmësja ligjore Aulona Bodo është i saktë.

Të njëjtin konstatim sikurse ndihmësja ligjore e gjejmë edhe në arsyetimin e vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, prej nga ku rezulton se midis tyre ka përputhje të plotë.

Dokumenti 5. Relacion për çështjen administrative që i përket paditësit Xh. D. kundër të paditurit Njësia Bashkiake Nr. ***, Tiranë, me objekt “Konstatimin e zgjidhjes së kontratës së punës nga punëdhënësi në mënyrë të menjëhershme e të pajustificuar. Detyrimin e palës së paditur të paguajë dëmshpërblimet: 12 paga mujore për arsye të pushimit të menjëhershëm pa shkaqe të justifikuara... etj”.

Ndihmësja ligjore ka pasqyruar qartë, saktë dhe plotësisht rrethanat e faktit, qëndrimin e gjykatave të faktit, pretendimet e palëve për mosmarrëveshjen, si dhe çështjet, shkaqet e ngritura në rekurs. Ajo ka identifikuar saktë legjislacionin e zbatueshëm për zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje administrative.

Ndihmësja ligjore ka analizuar zgjidhjen në themel të çështjes nga gjykatat e faktit me pasojë respektimin e ligjit material nga ana e tyre në zgjidhjen e çështjes, duke e vlerësuar atë të bazuar ligjërisht.

Ndihmësja ligjore ka marrë në analizë pretendimet e palës së paditur të parashtruara në rekurs, duke i vlerësuar ato të pabazuara, si dhe të pambështetura në parashikimet e nenit 58 të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Vlerësohet se relacioni i përpiluar nga ndihmësja ligjore Aulona Bodo është i saktë.

Konstatohet një përputhje e plotë midis mendimit të ndihmësës ligjore Aulona Bodo dhe vendimmarrjes së Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë në rastin konkret.

Të dhëna nga burime arkivore të KLGJ-së

9. Nga analiza e të dhënave të rezultuara nga përmbajtja e formularit të vetëvlerësimit, por edhe e akteve të tjera pjesë e dosjes së vlerësimit, konstatohet se subjekti i rivlerësimit Aulona Bodo deri më sot nuk ka ushtruar asnjëherë funksionin e gjyqtarit pranë ndonjë gjykate të shkallës së parë apo Apeli, prandaj për këtë subjekt nuk ka të dhëna në burimet arkivore të KLGJ-së për periudhën e rivlerësimit.

10. Si rezultat, të dhënat profesionale dhe etike për këtë subjekt janë marrë nga Gjykata e Lartë, ku znj. Aulona Bodo ka ushtruar detyrën si ndihmëse ligjore.

Analiza e gjetjeve

11. Analiza e gjetjeve u referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti; (ii) 5 dokumenteve ligjore të vëzhguara të përzgjedhura me short.

12. Procesi i rivlerësimit kalimtar të ndihmësve ligjorë pranë Gjykatës së Lartë parashikohet dhe rregullohet nga neni 42, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe nga neni 165 i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

13. Nga 8 dokumentet e vëzhguara, rezultoi se subjekti i rivlerësimit Aulona Bodo shfaq aftësi të larta në drejtim të interpretimit dhe të zbatimit të ligjit. Dokumentet ligjore të vëzhguara konfirmojnë njohuritë e saj kryesisht në të drejtën administrative, por edhe civile, duke përfshirë aspektet procedurale dhe materiale, që lidhen me llojin e detyrës që ajo ka ushtruar gjatë periudhës së rivlerësimit – ndihmëse ligjore në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë.

14. Në të 8 dokumentet e vëzhguara, rezultoi se ndihmësja ligjore Aulona Bodo, në çdo rast, evidenton saktë dhe qartë rrethanat e mosmarrëveshjes, vlerëson nëse rekursi është ushtruar brenda afatit ligjor, si dhe nëse rekursi i është drejtuar palës ndërgjyqëse respektive. Në relacionet e përgatitura prej saj nuk mungon analiza ligjore e vendimit gjyqësor ndaj të cilit është ushtruar rekurs, si nga pikëpamja e zbatimit të ligjit procedural, ashtu edhe në drejtim të zbatimit të ligjit material lidhur me zgjidhjen në themel të çështjes.

15. Rezultoi se subjekti i rivlerësimit Aulona Bodo ka përmbushur detyrimin e parashikuar nga neni 165, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke marrë pjesë në testimin e aftësive profesionale të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës enkas për ndihmësit ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë dhe gjykatave administrative të shkallës së parë dhe ato të Gjykatës Administrative të Apelit.

16. Kështu, Shkolla e Magjistraturës, këshilli drejtues me vendimin nr. ***, datë 21.5.2018, ka vendosur: “Të miratojë rezultatet e testimit profesional të subjekteve *ex officio* të shpallura nga komisioni i mbikëqyrjes së vlerësimit elektronik (faza e parë) dhe komisioni i vlerësimit të testit (faza e dytë), sipas listave bashkëngjitur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij”.

17. Nga përmbajtja e të dhënave të evidentuara në tabelën me pikët përfundimtare të fazës së dytë, pjesë përbërëse e vendimit nr. ***, datë 21.5.2018, të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, rezultoi se ndihmësja ligjore Aulona Bodo mori në total 122 pikë, nga 200 pikë që ishte maksimumi i parashikuar në tabelë.

18. Në funksionin e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë, znj. Aulona Bodo ka deklaruar se në periudhën 3.12.2014 – 18.10.2016 numri i përgjithshëm i dosjeve të studiuara, të përfunduara prej saj është 593.

19. Rregullorja e brendshme e Gjykatës së Lartë ka përcaktuar si standard minimal pune për ndihmësit ligjorë përgatitjen prej tyre, studimin prej tyre të të paktën 20 dosjeve gjyqësore në muaj.

20. Rrjedhimisht, ndihmësja ligjore Aulona Bodo ka përmbushur dhe tejkaluar standardin sasior të përpunimit të dosjeve gjyqësore, të parashikuar në rregulloren e brendshme të Gjykatës së Lartë.

21. Nga të dhënat e dërguara nga Gjykata e Lartë me shkresën nr. *** prot., datë 9.3.2023, nuk rezultojnë të dhëna negative për etikën në punë të znj. Aulona Bodo, për periudhën gjatë së cilës ajo ka ushtruar detyrën e ndihmëses ligjore pranë asaj gjykate (3.11.2014 – 8.10.2016). Gjithashtu, nga përmbajtja e shkresës së sipërcituar rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë objekt i ndonjë procedimi disiplinor për shkelje discipline.

22. Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Aulona Bodo në formularin e vetëvlerësimit, nga të dhënat që përmbajnë dokumentet që shoqërojnë formularin e vetëvlerësimit, nga të dhënat e dërguara nga Gjykata e Lartë, por edhe nga dokumentet e vëzhguara e të përzgjedhura me short, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna negative në lidhje me imunitetin e subjektit të rivlerësimit ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

23. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 relacionet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit për të bashkëpunuar me gjyqtarët, kolegët e tyre dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

24. Ndërkohë, në asnjë prej relacioneve të vëzhguara dhe praktikave përkatëse nuk evidentohet problematikë në bashkëveprimin e subjektit të rivlerësimit me gjyqtarin të cilin ajo ka asistuar.

Konkluzion i Komisionit

25. Për sa më sipër, nuk u konstatuan problematika lidhur me 3 dokumentet ligjore të paraqitura dhe 5 dokumentet ligjore të vëzhguara, të përzgjedhura me short për subjektin e rivlerësimit.

26. Pranë Komisionit, për subjektin e rivlerësimit Aulona Bodo nuk janë administruar denoncime nga publiku.

Çështje të tjera

Në lidhje me kërkesën e subjektit të rivlerësimit për emërimin e saj si gjyqtare

27. Subjekti i rivlerësimit me paraqitjen e shpjegimeve rreth rezultateve të hetimit në lidhje me tri kriteret e vlerësimit, atë të pasurisë, figurës dhe të aftësive profesionale, i kërkoi Komisionit konfirmimin si këshilltare ligjore të Gjykatës së Lartë me statusin e magjistratit dhe emërimin si gjyqtare e Republikës së Shqipërisë.

28. Në lidhje me këtë kërkesë, subjekti parashtroi si vijon: *“Me hyrjen në fuqi të ligjit kushtetues nr. 76/2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në cilësinë e subjektit të rivlerësimit kam pasur pozicionin e ndihmësit ligjor pranë Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, duke u bërë në këtë mënyrë subjekt i procesit të rivlerësimit, referuar nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 165, pika 1 e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.*

Në pikën 4 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë është parashikuar shprehimisht se: “ Të gjithë këshilltarët ligjore pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së

Lartë, ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, ndihmësit ligjorë pranë Prokurorisë së Përgjithshme do të rivlerësohen ex officio. Procesit të rivlerësimit mund t'i nënshtrohen me kërkesë dhe nëse plotësojnë kriteret sipas ligjit edhe ish-gjyqtarët, ish-prokurorët, ish-këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën tre vjet...”.

Në pikën 7 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë është parashikuar se: “Moskalimi me sukses i procesit të rivlerësimit përbën shkak për mbarimin e menjëhershëm të ushtrimit të detyrës, krahas shkaqeve të parashikuara në Kushtetutë. Gjyqtarët dhe prokurorët, përfshirë ata që janë deleguar në pozicione të tjera, ish-gjyqtarë ose ish-prokurorë, të cilët kalojnë me sukses rivlerësimin, qëndrojnë në detyrë ose emërohen gjyqtarë e prokurorë. Subjektet e tjera, të cilët kalojnë me sukses rivlerësimin, emërohen gjyqtarë ose prokurorë, sipas ligjit”.

Ky qëndrim i shprehur në Kushtetutë është reflektuar dhe parashikuar qartësisht edhe në nenin 58, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në të cilën është parashikuar shprehimisht se: “Në rast se subjektet e rivlerësimit, sipas nenit 179/b, pika 4, fjalia e dytë³⁵, të Kushtetutës, kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit, Komisioni mund të vendosë: a) emërimin si gjyqtar ose prokuror, në përputhje me dispozitat e legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve; b) refuzimin e emërimit si gjyqtar ose prokuror, në përputhje me dispozitat e legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve”.

Pavarësisht faktit se në këtë dispozitë ligjvënësi u është referuar ngushtësisht subjekteve të rivlerësimit që janë ish-gjyqtarët, ish-prokurorët dhe ish-këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën tre vjet, parashikimet e saj janë të vlefshme për të gjitha subjektet ex officio që mbajnë aktualisht detyrën e këshilltarit ligjor në Gjykatën Kushtetuese apo Gjykatën e Lartë, të cilët kanë të paktën 3 vjet që ushtrojnë këtë detyrë. Kjo për faktin se ligji nuk mund të kufizojë dhe nuk mund të vërë në pozita të pabarabarta subjektet të cilat vetë akti themeltar i shtetit, Kushtetuta, i ka vënë në të njëjtin nivel dhe pozicion, duke mos bërë asnjë lloj dallimi mes tyre.

Lind pyetja se përse subjektet ex officio, të cilët kanë ushtruar detyrën e këshilltarit ligjor pranë Gjykatës Kushtetuese ose Gjykatës së Lartë për një periudhë trevjeçare, por që aktualisht nuk e ushtrojnë më atë, janë më të favorizuar nga ligji për t'u emëruar direkt gjyqtarë ose prokurorë nga Komisioni (nëse i nënshtrohen procesit të rivlerësimit me kërkesë dhe arrijnë ta përfundojnë atë me sukses), sesa subjektet e tjera që e kanë ushtruar këtë detyrë për një periudhë jo më të vogël se tre vjet dhe që vijojnë ende ta kryejnë atë, duke pasur edhe një përvojë profesionale në fushën e të drejtës, në rastin tim prej më shumë se 10 vitesh?!

Pra, qartësisht organet e rivlerësimit kanë të drejtë që të emërojnë si magjistratë subjektet e tjera ex officio, që nuk e ushtrojnë detyrën e gjyqtarit dhe të prokurorit në kohën e vlerësimit të tyre, nëse e kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit. Ndërsa caktimi i detyrës si gjyqtar apo prokuror i këtyre subjekteve pasi fitojnë statusin e magjistratit, është detyrë ekskluzive e organeve kompetente të ngarkuara me ligj që drejtojnë sistemin gjyqësor, KLGJ dhe KLP, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

³⁵ Subjektet që mund t'i nënshtrohen me kërkesë procesit të rivlerësimit.

Interpretimi i normave ligjore të mësipërme mendoj se vjen tërësisht në përputhje edhe me rekomandimet e dhëna nga Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë në vitin 2019, të cilët kanë rekomanduar që këshilltarët ligjorë që ushtrojnë veprimtarinë e tyre profesionale pranë gjykatave më të larta të sistemit të drejtësisë dhe zhvillimit të karrierës profesionale, si dhe puna e kryer prej tyre shfaq një rëndësi të veçantë në dhënien e drejtësisë, referuar CCJE Opinion No. 22 (2019) The Role of Judicial Assistants, pikës 11, 12, 15, 16, 46, 47 dhe 48 të tij. Ata kanë të drejtë të avancojnë në karrierë brenda sistemit të drejtësisë për shkak të natyrës së punës që ata kryejnë dhe pas asnjë lloj barriere arsimore të mëtejshme.

I kërkoj Komisionit që të marrë në analizë dhe të bëjë një interpretim origjinal të dispozitës kushtetuese, konkretisht nenit 179/b, pika 7, fjalia e fundit e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe një interpretim pajtues dhe në përputhje me normën kushtetuese të nenit 58, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë”.

Përfundimisht, bazuar në dispozitat e mësipërme, pra nenit 179/b, pika 7, fjalia e fundit, nenit 58, pika 1, shkronja a dhe pika 2 e ligjit nr. 84/2016, kërkoj nga ana e këtij Komisioni:

Konfirmimin në detyrën e këshilltarit ligjor të Gjykatës së Lartë me statusin e magjistratit dhe emërimin si gjyqtare e Republikës së Shqipërisë”.

Vlerësimi i Komisionit në lidhje me kërkesën e subjektit të rivlerësimit për t’u emëruar si gjyqtare

29. Subjekti i rivlerësimit kryen aktualisht detyrën e këshilltares ligjore pranë Gjykatës së Lartë, marrëdhënie e pandërprerë që në vitin 2014, vit kur është emëruar si ndihmëse ligjore nga ana e kësaj Gjykate.

30. Në kushtet kur ndaj subjektit të rivlerësimit nuk është kryer procesi i rivlerësimit si ish-ndihmëse/këshilltare ligjore, por si subjekt në detyrë, nuk gjejnë zbatim dispozitat kushtetuese dhe ligjore, që janë: neni 179/b, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe neni 58, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

31. Për sa kohë subjekti e ushtron këtë detyrë prej kohësh dhe i është nënshtruar procesit të rivlerësimit si subjekt *ex officio* dhe jo me kërkesën e saj, si ish-ndihmëse/këshilltare ligjore, pavarësisht faktit se ajo e ka kaluar me sukses këtë proces rivlerësimi kalimtar për të tria kriteret e vlerësimit, në përfundim të këtij procesi ndaj saj nuk mund të zbatohen dispozitat e nenit 58/2 të ligjit nr. 84/2016.

32. Sa më sipër, Komisioni e refuzoi këtë kërkesë të subjektit të rivlerësimit Aulona Bodo, duke vendosur mospranimin e saj për shkak të statusit aktual të subjektit të rivlerësimit, sipas të cilit subjekti e mban detyrën e ndihmësit/këshilltarit ligjor pranë Gjykatës së Lartë që prej vitit 2014 e në vazhdim.

Vlerësimi i Komisionit për aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit

33. Në përfundim, Komisioni vlerësoi se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit Aulona Bodo ka treguar cilësi të mira në punën e saj, si dhe është efiçente e efektive dhe konsiderohet “e aftë”, duke arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në kuptim të shkronjës “c” të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Aulona Bodo ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas parashikimit të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, referuar shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58, si dhe pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Aulona Bodo, ndihmëse/këshilltare ligjore në Gjykatën e Lartë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 19.9.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Genta Tafa (BUNGO)

Kryesuese

Roland ILIA

Relator

Xhensila PINE

Anëtare

Sekretare gjyqësore

Amela Idrizi